REVISTA E KOMUNITETIT SHQIPTAR NE BRITANINE E MADHE - MAGAZINE FOR THE ALBANIAN COMMUNITY IN THE UK AND REPUBLIC OF IRELAND

# ALBANIAN POST

Nr. 35

KORRIK / JULY 2021

**Editor in Chief:** Dr. Fatmir Terziu - **Telephone:** 07984497444 - contact@fjalaelire.com - www.fjalaelire.com

14 Ligjet për Europianët...

13 "Përvoja" shqiptare në dietat...




22 Romani "Besa"...

# BRITANI E MADHE INTERES NË RRITJE PËR ATË ÇKA SHQIPËRIA OFRON

**1. Thirrje për të aplikuar për tu bërë pjesë e "ekipit të ëndrrave"**

**2. Një impakt i rendësishëm social për zonën e Dibrës dhe më gjerë**

**3. Shtetasit shqiptar, që jetojnë jashtë duhet t'i drejtohen platformës E-Albania**

**4. 15 korrik fillojnë fluturimet nga Kukësi në drejtim të Turqisë dhe Zvicrës**

**5. mjaft shpejt do të kemi lajme të mira në këtë drejtim edhe për Londrën**

Udhëtimi në Shqipëri tashmë ka një hapësirë tjetër, atë që vjen si shkak dhe fakt i ndërtimit të Aeroportit të Kukësit. Shqiptarët janë në pritje të një ëndërre të tillë që është tashmë realitet. Fakte të tjera të reja afrojnë akoma më shumë Shqipërinë me Britaninë e Madhe. Pandemia krijoi mjaft probleme dhe mes kësaj problematike Ambasada shqiptare ndjehet mjaft e angazhuar që të ndërtojë procedura më të lehta për kërkesat komunitare.

*(vijon në faqen 02)*

24/7 orë linjë emergjence
07878335000

RASHID & RASHID
Solicitors, Advocates
Immigration Specialists
Commissioners of Oaths

Këshilla ligjore FALAS

Specialist i azilit të trafikimit njerëzor

RASHID & RASHID LAW FIRM
190 Merton high street,
Wimbledon, London, SW19 1AX
solicitors@rashidandrashid.co.uk
Tel: 02085401666

*(vijon nga faqja 01)*

...Gjithashtu ka dhe të reja të tjera, angazhime, dhe mbi të gjitha respekt në rritje… Këto e mjaft të tjera duan një hapësirë për lexuesin tonë. Ndaj, jo thjesht në shenjë angazhimi, por me respektin angazhues Diplomatik që gëzon stafi i Ambasadës shqiptare në Londër, iu drejtuam Shkëlqesisë së Tij, Ambasadorit të Jashtëzakonshëm dhe Fuqiplotë të Republikës së Shqipërisë në Britani të Madhe dhe në Republikën e Irlandës, z. Qirjako Qirko, për të marë më shumë informacion në lidhje me aktualitetet dhe angazhimet e trupit diplomatik të kësaj ambasade në këtë kohë të vështirë pandemike. Gjithashtu me këtë intervistë, sikurse e cituam, synuam të bëjmë më të lehtë disa njohje ligjore dhe mjaft angazhime të tjera që lehtësojnë mjaft nga kërkesat e shqiptarëve, që kanë nevojë për shërbimet që afron Ambasada e Shqipërisë dhe shërbimi saj konsullor.

**Pyetje:** Zoti Ambasador, Qirkjako Qirko, si u përballua situata e vështirë pandemike në një vit e gjysëm dhe çfarë angazhimesh keni patur në këtë periudhë në drejtim të prezantimit të potencialeve ekonomike të vendit tonë?

**Përgjigje:** Ashtu siç ju me të drejtë e përmendët periudha e goditjes nga pandemia ka qenë një periudhë e vështirë dhe me një impakt negativ global në shumë aspekte të jetës ekonomike, politike e sociale. Megjithatë, sikurse njeriu si një qënie që "është i dënuar" të përshtatet në çdo situatë, jemi përpjekur që duke iu adoptuar kushteve të krijuara, që të përpiqemi të bëjmë më të mirën në funksion të detyrës. Dhe në përgjigje të pyetjes tuaj unë do ta konsideroja një zhvillim pozitiv pjesëmarrjen e një konsorciumi britanik në tenderin për ndërtimin e aeroportit të Vlorës. Pavarësisht rezultatit pjesëmarrja për herë të parë e një grupi kompanish nga Mbretëria e Bashkuar, në një konkurim të tillë, është padyshim tregues i interesit në rritje për atë çka Shqipëria ofron.

Do të ishte me interes të tregoja dhe për një takim që kam zhvilluar pak ditë më parë me Presidentin për Europën, Afrikën dhe Lindjen e Mesme të Kompanisë Bechtel, Ambasadorin Justin Siberell. Ambasadori Siberell, një personalitet i jashtëzakonshëm, me një karrierë 27 vjeçare në Shërbimin e Jashtëm të SHBA prej një viti është edhe President i kompanisë së mirënjohur Bechtel për rajonet e sipërpërmendura. Sikurse e dini pak kohë më parë Qeveria shqiptare dhe Kompania Bechtel njoftuan se ndërtimi i hidrocentralit të Skavicës do të bëhet me fondet e qeverisë së SHBA dhe se për ndërtimin e tij do të angazhohet kompania Bechtel e cila ka nje experiencë disa dhjetëra vjeçare në këtë fushë.

Nga biseda që zhvillova me Ambasadorin Siberell mësova se ndërtimi i këtij hidrocentarali do të ketë impakt shumë pozitiv në disa fusha, sikurse është në radhë të parë shfryqëzimi tërësor i fuqisë energjitike të lumit Drin. Me ndërtimin e këtij hidrocentrali ekonomizohet shfrytëzimi i ujërave të Drinit edhe në raport me hidrocentralet e tjerë në këtë lumë si Komani, Fierza dhe Vau i Dejës, si dhe ajo që është shumë e rendësishme për një pjesë të konsiderueshme të banorëve të nën-Shkodrës do të shmangë përmbytjet për këtë zonë. Përveç kësaj, ndërtimi i këtij hodrocentrali do të ketë një impakt të rendësishëm social për zonën e Dibrës dhe më gjerë, pasi për ndërtimin e tij do të angazhohen disa mijëra punëtorë dhe një numër shumë i konsiderueshëm specialistësh të fushave të ndryshme. Nga ana tjetër ndërtimi i këtij hidrocentrali do të bëjë një "revolucion" të vërtetë në fushën infrastrukturore të rajonit duke e kthyer atë jo vetëm në një zonë me infrastrukturë moderne, por edhe një zonë që do të njohë një rritje të paparë të turizmit.

**Pyetje:** Me një staf të reduktuar në numër keni mundur të përballoni një ngarkesë të jashtëzakonshme pune. A mund të na thoni diçka më shumë për këtë angazhim si dhe për procedurat që duhet të ndjekin shtetasit tanë kur ju nevojiten shërbimet konsullore të ambasadës sonë?

**Përgjigje:** Ju falënderoj për pyetjen pasi më jepet mundësia që në këtë mënyrë ti përgjigjem edhe shumë paqartësive që kanë shtetasit tanë për ofrimin e shërbimeve konsullore nga ana e Ambasadës. Do ta quaja pa ekzagjerim një "revolucion", atë që qeveria shqiptare, ka bërë në drejtim të ofrimit të shërbimeve online për shtetasit tanë. Sot janë mbi 150 shërbime të cilat ofrohen online pa pasur nevojë të paraqitesh fizikisht pranë zyrave të gjendjes civile dhe zyrave konsullore pranë ambasadave, apo zyrave të tjera të shtetit shqiptar.

Konkretisht që çdo shërbim konsullor, që kanë nevojë shtetasit... (vijon në faqen 06)



# TASHMË ERDHI AJO QË JU DUHEJ PËR DËRGESAT TUAJA: KOMPANIA "BLEDI LTD"

Mjaft kompani transporti e nisn me një slogan sikur janë qindra vjecarë në këtë profesion të ri të tyre. Dhe më së shumti duan të theksojnë se kanë kryer dhe transporte të mëdha, kur dihet se si njëra dhe tjetra janë vetëm tentativa dhe lojëra fjalësh.

Kompania "Bledi Ltd" mbetet më e saktë dhe me një eksperiencë të gjatë, natyrisht jo vetëm në Shqipëri dhe Angli dhe në destinacione të tjera ndërkombëtare në fushën e transportit ndërkombëtar të mallrave dhe mjeteve të ndryshme, ofron për të gjithë klientët e saj një shërbim të kompletuar dhe sigurt transporti.

Siguria, shpejtësia dhe garancia e punës së zhvilluar ndër vite ka bërë që sot shumë bashkëathetarë dhe miq, të tjerë të lidhur me Atdheun tonë të dashur dhe mjaft anglezë madje që kanë shkuar të investonë në Shqipëri, po aq dhe imigrantët që jetojnë, punojnë dhe studiojnë, prej shumë vitesh ne Britani të Madhe dhe në Europë kanë ardhur në pikën më të mirë të mirëkuptimit të na besojnë transportin e mallrave të tyre drejt Shqipërisë.

Duam të themi se kjo kompani e njohur tashmë nga eksperienca e saj dhe nga aktiviteti serioz, po aq dhe nga respekti, nga përkushtimi dhe përgjegjësia e plotë gjatë gjithë procesit të grumbullimit të mallit deri në dorëzimin e tij në destinacionin final, mbetet konkurruese dhe në çmime. Ajo mund të kontaktohet në numrat e telefonit ose në ËhatsApp, Viber, Facebook, Instagram dhe e-Mail për tu informuar mbi datat dhe lokacionet e grumbullimit dhe shpërndarjes së mallit. Misioni i kësaj kompanie është të vazhdoj rrugën e suksesit në vijimin dhe përmbushjen e standarteve të një shërbimi transporti modern dhe efikas, me një garanci, mosprishje të mallrave, dhe me dërgimin pa probleme të tyre. Vizioni natyrisht mbeteti qartë, të vazhdoj të mbetet një kompani lider i padiskutueshëm në transportin e Mallrave nga Britania e Madhe dhe vende të tjera të Europës drejt Shqipërisë dhe anasjelltas.

Kjo kompani funksionon me furgonë të posaçëm për këtë punë dhe me dy drejtues makinash të sprovuar në mjaft vende të huaja.

Nëse jeni duke kërkuar për një kompani cilësore, efektive, transparente, kompetente, të besueshme dhe profesionistësh, atëherë "Bledi Ltd" është zgjedhja e juaj e duhur dhe e domosdoshme në çdo kohë.

Me "Bledi Ltd" e gjitha që ju dërgoni dhe prisni të merrni në destinacionin tuaj është në dorë të sigurtë dhe me garanci të plotë.

Mbi 50kg i marrim dhe i dërgojmë në destinacion.

Respekt-Shpejtësi-Saktësi-Garanci-Kualitet

TRANSPORT MALLRASH: ANGLI-SHQIPËRI & SHQIPËRI-ANGLI

ANGLI:
+447 39 528 7400
+447 49 294 5825

SHQIPËRI:
+355 67 728 2828
+355 69 470 5893

# “KOHA” E FADIL MAQEDONCIT FRYMËZON GJITHNJË

Gjashtë muaj më parë pronari shqiptar i Restorantit “Koha” në Londër, Fadil Maqedonci, ishte në plan të parë të gazetës britanike “Evening Standard”, ku gazeta në fjalë fliste se “Bizneset në Londër kishin koston “shkatërruese” të bllokimit nga Covid-19, ndërsa thuhej se “numri i njerëzve që vizituan West End ra 84% në atë që duhej të ishte fundjava e parë e “zyrtare” e kohës festive”.

Sot, në ditën e njëzetë e pestë të qershorit të 2021-shit, Fadil Maqedonci, flet jo vetëm për atë kohë të vështirë, por dhe për virusin dëmtues që ai vetë e përjetoi keq, ndërsa e ndjeu dhe më tej me sportivitet dhe me mjekim ia gjeti të kalonte kohën e keqe shëndetësore e të gjendej sërrish në krye të planeve të tij, në biznesin e tij, me të cilin ka bërë jo vetëm emër të mirë për shqiptarët, por vërtet epokë.

Nga ajo kohë kur gazta e lartcituar shkruante se “pjesë të Londrës qendrore mbetën kryesisht të shkreta pavarësisht përpjekjeve më të mira të drejtuesve të biznesit për të “filluar festivitetin herët” duke ndezur dritat e rrugës “Oxford”, sot mjaft problematika të tjera janë krijuar si pasojë e hamendësive të ndryshme lidhur me kohë-pushimet verore të qytetarëve britanikë.

Ekonomistët me kohë kishin vlerësuar se “qëndrimi në shtëpi” do t’i kushtojë ekonomisë së Londrës një shtesë prej 6 miliardë fstërlina në prodhimin e humbur, kryesisht në sektorët e saj të mëdhenj të shitjes me pakicë dhe mikpritjen”.

Fadil Maqedonci në atë kohë, shrehej se “ishte gjithmonë i gatshëm për të bërë gjënë e duhur për të mbrojtur shëndetin publik, por mbyllja e restoranteve vërtet krijon humbje, disorientim biznesi, prishje planesh dhe natyrisht ka pasoja të rënda edhe për Londrën.” Qyteti ende edhe pse ka disi gjallëri akoma mbete që nga ajo kohë në mënyrë disproporcionale më i varur nga këta sektorë se çdo qytet tjetër në vend, duke siguruar jetesë për mbi 300,000 njerëz. Për çdo ditë që grilat në atë kohë mbetën të mbyllura dhe akoma më keq kur ven dosej bllokimi, shumë prej këtyre vendeve të punës ishin në rrezik dhe bizneset natyrshëm humbnin para. Unë, na thotë Fadili, në një bisedë miqësore, natyrshëm u dnjeva keq, por akoma më keq e pashë veten kur dola në Qendër të Londrës, dhe nuk shihja snjë njeri, madje dhe ata të pastrehët e rrugëve mungonin.

E dija se bllokimi kishte humbje për biznesin, por në rallë të parë mendova shëndetin, se ashtu sikurse. Nisa nga e para, përsëri do të rikthehem me forca të tjera, e dija vazhdon, Fadili, se bllokimi do t’i kushtonte biznesit një shtesë prej 1 milion to deri në 1.5 milion stërlina. Ndërsa jemi bashkë nis e rilexoj gazetën “Evening Standard” të gjshtë muajve më parë dhe mbetem fjalë për fjalë në atë që shkruan kjo gazetë: “Fadil Maqedonci, pronar i restorantit dhe lokalit Cafe Koha afër Sheshit Leicester ku tregtia ka qenë e dobët që nga marsi, tha: “Nuk mund t’ju them se sa të dëshpëruar jemi, mënyra sesi po shkojnë gjërat, është shkatërruese. Ne thjesht po bëjmë disa kafe për disa njerëz të zakonshëm që po kalojnë, por ne madje nuk po tarifojmë për to. Nuk ia vlen sepse atëherë do të duhet të vëmë të gjitha shenjat vetëm për ngritjen në ajër.” Gazeta shkruan më tej: “Z. Maqedonci tha se ai kishte vendosur rreth 160,000 stërlinave të kursimeve në biznes, i cili punëson 20 persona, për ta mbajtur atë në këmbë. Ai gjithashtu ka krijuar gati 100,000 stërlina në borxhe të prapambetura, të cilat ai tha se mund të duheshin katër vjet për t’u shlyer.”

“Shpenzimet nga vizitorët jashtë shtetit në Londër janë tashmë poshtë 97%, sipas shifrave të Zyrës për Statistikat Kombëtare. Të dhënat e reja të shitjes me pakicë nga Springboard tregojnë se rënia në të gjithë destinacionet e shitjes me pakicë u ul javën e kaluar me 15.4% nga java më parë.” Kjo i përkiste gjashtë muajve më parë…

Sot disi më ndryshe. Afër restorantit “Koha” ka përsëri zhurmë. Një art-riprodhim me çanga, kuaj, lopë dhe karroca, duke vënë maketimin artistik që simbolizon disa shtete europiane, sidomos Zvicrën malore dhe të bukur duket se jo vetëm josh, por edhe bën me dije se diku afër janë dhe piktorët e rrugës, që presin klientët e rastit. Maskat thuhet se do të hiqen së shpejti, por ende afër teatrove dhe institucioneve të tjera shikon dhe ndjen lëvizjet e duarve të qytetarëve të vendosin shpejt maskat. Sakaq kjo ndjehet edhe në ambiente të tjera.

Tek “Koha” nuk është fare qetë, ka lëvizje, por jo më si më parë. Aty bien në sy fotografitë e shkrimtarëve më në zë të Kombit shqiptar dhe natyrshëm mjaft gjëra që marrin frymë dhe frymëzojnë shqiptarisht. “Koha” është vërtet koha që frymëzon, jep shresë, jep forca si në kohën kur ajo foli me kohën e duhur dhe në kohën e duhur për shqiptarët në nevojë të trungut shqiptar, Kosovës.

**RASHID & RASHID**
Solicitors, Advocates
Immigration Specialists
Commissioners of Oaths

# Këshilla ligjore FALAS

Specialist i azilit të trafikimit njerëzor

- Dokumente udhëtimi
- Procedura për leje qëndrimi dhe viza
- Kur jeni kotigjent per t'u riatdhesuar ose të ndaluar nga organet e emigracionit
- Mbulojmë të gjitha aspektet e emigracionit
- Zgjatje vizash
- Leje pune
- Rishikim jurdik
- Apelim Tribunali
- Rastet e trashëgimisë

**24/7 orë linjë emergjence**

**07878335000**

**Rashid & Rashid Solicitors, si të gjithë avokatët e tjerë në praktikë në Angli dhe Uells, është Kompani e autorizuar dhe e rregulluar nga Autoriteti i Rregullimit të Aplikantëve.**

**Avokatët tanë të emigracionit kanë mbi dhjetë vjet përvojë në fushën e emigracionit dhe ligjit të azilit.**

**RASHID & RASHID LAW FIRM**
190 Merton high street,
Wimbledon, London, SW19 1AX
solicitors@rashidandrashid.co.uk
**Tel:** 02085401666

*(vijon nga faqja 02)*

...shqiptar, që jetojnë jashtë duhet t'i drejtohen platformës E-Albania. Pasi të gjejnë shërbimin për të cilin kanë nevojë do t'ju duhet të ndjekin hapat të cilat i dikton platforma. Pasi kryejnë edhe pagesën online në adresën bankare të ambasadës që të përcjell platforma, shkohet në ambasadë për të tërhequr fizikisht lejen e kalimit, prokurën, pasaportën biometrike, apo kartën e identitetit.

Për këto dy dokumente të fundit do të ishte e nevojshme paraqitja dy herë në ambasadë. Herën e parë, pasi ke aplikuar online dhe platforma E-Albania të ka percjellë datën dhe orën e takimit, prezenca e shtetasit është e nevojshme për të kryer procedurën e lënies së gjurmëve të gishtave dhe kryerjes së fotografisë. Herën e dytë do të vihet në Ambasadë për të tërhequr pasaportën dhe kartën e identitetit, mbi bazën e njoftimit që shtetasi do të marrë në këtë rast nga Ambasada.

Nga kontaktet që kemi me bashkëatdhetarët tanë kemi konstatuar se ka edhe raste kur individë spekullantë, që unë nuk do të hezitoja ti quaja edhe kriminelë, duke shfrytëzuar mosdijen apo hezitimin që jo rrallë shtetasit kanë për të aplikuar në plaftformë, kërkojnë shuma që shkojnë deri në 400 stërlina për kryerjen e një aplikimi. Do ti bëja thirrje gjithë lexuesve të gazetës tuaj që në asnjë rast të mos i drejtohen këtyre individëve "për ndihmë". Të përpiqen të aplikojnë vetë në platformë, pasi aplikimi është i thjeshtë dhe i ndërtuar në atë formë, që çdo shtetas mund ta kryejë vetë dhe nëse nuk ja del dot punonjësit konsullorë në Ambasadë do ti ndihmojnë.

Nga ana tjetër duke ju përgjigjur dhe interesit tuaj dua t'ju them se volumi i punës në sektorin konsullor është rritur në mënyrë të jashtëzakonshme. Për këtë do të ju jap vetëm një fakt. Javën e kaluar nga zyra konsullore e kësaj ambasade janë kryer 1773 veprime konsullore (kryesisht pasaporta dhe karta identiteti). Kjo punë e realizuar në një javë është më shume se veprimet konsullore që kjo ambasadë ka kryer gjate 5 muajve të pare të vitit 2016. Me këtë rast do të desha të falenderoja konsullin z. Golli dhe stafin konsullor (dy operatorët) për angazhimin dhe përgjegjësinë që kanë patur në plotësimin e detyrave.

Gjithashtu besoj se shumë shpejt do të përfundojmë dhe përmirësimin e ambienteve ku kryhet shërbimi konsullor duke rritur cilësinë dhe shpejtësinë e shërbimit.

**Pyetje:** Kur mendoni se do të fillojë nga puna linja Londër-Kukës dhe a ka ndonjë mundësi që Shqipëria të konsiderohet Green nga shteti britanik?

**Përgjigje:** Sikurse e dini ka qenë një angazhim personal nga ana e Kryeministrit Edi Rama për ndërtimin dhe bërjen funksional të aeroportit të Kukësit. Shumëkush ka qenë skeptik për këtë premtim, por sot ky aeroport është realitet. Siç jeni në dijeni në 15 korrik fillojnë fluturimet nga Kukësi në drejtim të Turqisë dhe Zvicrës. Kjo do të thotë se ky aeroport i ka kaluar të gjitha testet që kërkojnë rregullat ndërkombëtare të aviacionit civil për lejimin e fluturimeve. Padyshim që masat kufizuese për përhapjen e Covid-19 pengojnë edhe në këtë drejtim. E them këtë pasi edhe personalisht jam përpjekur për të lehtësuat ardhjen në Londër të administratorit të aeroportit të Kukësit për të zhvilluar bisedime me homologët e tij, por rregullat britanike janë hermetike për sa i përket karantinimit 10 ditor dhe kjo padyshim përbën një vështirësi jo të vogël për dikë të angazhuar në biznes. Megjithatë jam në dijeni dhe të kontakteve në nivele të tjera më të larta dhe besoj se mjaft shpejt do të kemi lajme të mira në këtë drejtim.

Për sa i përket pjesës së dytë të pyetjes tuaj dua të ju them se tashmë lidhur me numrin e të infektuarve për 100 mijë banorë Shqipëria faktikisht është Green, por këtë realitetet duhet ta njohin autoritetet ndërkombëtare, që monitorojnë rritmet e uljes, apo rritjes së përhapjen të sëmundjes.Ajo që duhet thënë në këtë rast është manexhimi fantastik që Qeveria shqiptare i bëri kësaj pandemie. Sikurse e dini tashmë spitalet Covid 2, 3 dhe 4 janë të mbyllur, ndërsa në spitalin Covid 1, apo tek infektivi ndodhen të shtruar më pak pacientë se gishtat e duarve.

Ndërkohë vaksinimi ka zbritur nën moshën 50 vjeç dhe deri në fund të muajit qershor besoj do të kapi shifrën e 1 milionë të vaksinuarve. Pavarësisht moshës janë vaksinuar edhe punonjësit e spitaleve dhe qëndrave shëndetësore (mjekë, inferimierë, laborantë), mësuesit, punonjësit e policisë, punonjësit e shërbimeve turistike, punonjësit e trasportit etj.

**Pyetje:** Si po punohet me brezin e dytë dhe të tretë të cilët kanë lindur në Britani për të mbajtur gjallë gjuhën dhe kulturën shqiptare? Ka ndonjë iniciativë të re nga ana e Qeverisë shqiptare për të tërhequr kontributin e intelektualëve të rinj në botë, apo dhe të emigrantëve të cilët duan të kontribuojnë për vendin e tyre?

**Përgjigje:** Për mua është viti i pestë që shërbej si ambasador këtu në Britani dhe një nga aktivitetet e përvitëshme që e kam shumë për zemër është pjesëmarrja në përfundimin e vitit shkollor të shkollave shqipe. Nuk e fsheh, që për mua është një moment shumë emocionues, kur dëgjon fëmijë të lindur e të rritur këtu në Britani të Madhe të cilët flasin dhe recitojnë aq bukur shqip, ndaj mirënjohja e pafund në këtë drejtim i përket mësuesve dhe mesueseve tona të mrekullueshme të cilat punojnë me aq shumë dashuri për mësimin e gjuhës shqipe. Kontributi i tyre në këtë drejtim është i pallogaritshëm, pasi mësimi i gjuhës amtare i mban njerëzit të lidhur me kombin, me historinë dhe kulturën e tij. Mësimi i gjuhës i mban të lidhur vogëlushët me njerëzit e tyre të dashur që kanë në Shqipëri, Kosovë e kudo ku ka shqiptarë. Mësimi i gjuhës shqipe është elementi i parë që na identifikon si komb ndaj për ruajtjen mbrojtjen dhe mësimin e saj çdo sacrifice ja vlen. Gjithashtu këto katër vitet e fundit një punë e mirë është bërë në këtë drejtim edhe nga ana e Ministrisë së Diasporës dhe Ambasadës së Republikës së Shqipërisë këtu në Londër. Tashmë nga të gjitha shkollat e gjuhës shqipe në Britani ne kemi mbledhur kërkesat për tekstet shkollorë për vitin e ardhëshëm dhe brenda muajit korrik do të bëjmë shpërndarjen e këtyre teksteve. Dhe sa herë flasim për këtë temë nuk është e tepërt ti shprehim gjithë mirënjohjen tonë Qeverisë së Madhërisë së Saj Mbretëreshës Elizabeth II, për mundësinë dhe mbështetjen që i jepet komunitetit shqiptar si dhe komuniteteve të tjera këtu në Britani të Madhe për të rruajtur e zhvilluar gjuhën dhe kulturën kombëtare.

Pjesa e... (vijon në faqen 07)

*(vijon nga faqja 06)*

...dytë e pyetjes tuaj mund të ishte edhe e para pyetje për sa i përket rëndësisë. E them këtë, sepse se në këto momente shteti shqiptar është i etur për kontributin e bashkëkombasve, kudo ku jetojnë. Kryeministri Rama sëfundi ka shpallur atë që është quajtur iniciativa "gati për Shqipërinë". Me anë të kësaj iniciative synohet që të orientohet dhe maksimalizohet kontributi i shqiptarëve të shkolluar kudo ku janë, në shërbim të vendit. Për këtë qëllim ,çdo shqiptar i cili dëshiron të punojë në Shqipëri, apo që mendon të kontribuojë për vendin me dijet e tij në projekte të ndryshme, qoftë online, duhet që të përcjellë një kërkesë për atë çka ai do të kontribuojë për vendin dhe një një CV të shkurtër në adresën e emailit gatipershqiperine@kryeministria.al. Më tej do të ketë një bashkëbisedim me Kryeministrin dhe një grup ekspertësh dhe për vazhdimin i interesuari njoftohet nga administrata e Kryeministrisë.
Sikurse dihet gjatë periudhës 2022-23 Shqipëria do të jetë anëtare e Këshillit të Sigurimit të OKB-së. Për këtë shkak Ministria e Jashtme ka ndërmarrë iniciativën për krijimin e "dream team", me anë të së cilës fton të rinj shqiptarë, të cilët kanë studiuar për marëdhënie ndërkombëtare, ose për fusha që lidhen me marëdhëniet ndërkombëtare për të aplikuar për tu bërë pjesë e "ekipit të ëndrrave", ekip i cili do të përfaqësojë vendin në këtë angazhim të jashtëzakonshëm të diplomacisë dhe shtetit shqiptar.

**Pyetje:** I nderuar z. Ambasador, ju lutem së fundi cili është mesazhi juaj për komunitetin shqiptar këtu në Britaninë e Madhe.

**Përgjigje:** Në fund të kësaj interviste dëshiroj t'ju falenderoj për mundësitë që më dhatë dhe të përsëris atë që e them shpesh: Çdo shqiptar këtu në Mbretërinë e Bashkuar duhet ta ndjejë vehten ambasador i vendit të tij, pasi aty ku jetoni, aty ku studioni në rrethin tuaj shoqëror apo miqësor ju jeni shqiptari, apo shqiptarja, që me sjelljen dhe angazhimet tuaja përpiqeni të bëni krenarë familjet tuaja dhe njëkohësisht edhe vendin, dhe kombin prej nga vini.
Sot më shumë se kurrë mendimi juaj, shkolla juaj, edukimi dhe kualifikimi, po aq dhe trajnimi dhe specializimi, si edhe eksperienca juaj janë të vlefshme për Shqipërinë, ndaj aplikoni në adresën

**gatipershqiperine@kryeministria.al**

Faleminderit revistës „Albanian Post" që gjithnjë ka qenë në krye të angazhimve të Komunitetit shqiptar në Britani të Madhe. Faleminderit Juve!

# NJË KRYEFJALË PËR RESPEKTIN

Vila "Ronel" Bar-Kafe dhe Restorant prej kohësh është sikurse e kam thënë publikisht një qendër e vogël shqiptare në Londër, një Shqipëri e vogël me tërë dimensionin e saj figurativ dhe kulturor. Dhe në këtë mjedis të bukur e të qetë, të mrekullueshëm në të gjitha aspektet një takim me njërëz, intelektualë, miq e të panjohur me të cilët shtrëngon duart për herë të parë mbetet jo thjesht memorje, as dhe një fiksim i thjeshtë i memorjes në fotografi, por një kapitull më vete, ku shtjellohet biseda, e prekshmja dhe e paprekshmja e tërë viteve lëvizje, udhëjetë, emigrim. Me prindërit e nderuar të Dr Kristo Papa, MD, natyrisht një shtrëngim duarsh dhe një takim i tillë mbetet privilegj, respekt që thellohet më shumë, dhe një hapësirë ku Njeriu gjen njerëzoren, kërkon përtej fjalëve dhe ndjesive, atë që vetë Njeriu e kumton deri në pikën e fundit të ndjesisë dhe dashurisë që ka Kryefjalë respektin dhe përkushtimin. Të dy mjaft patriotë, të prekshëm dhe të ndjeshëm, të dy me një zemër të hapur për Shqipërinë dhe për shqiptarët, të dy me një zemër të ndarë sa në Vlorë e në pikat e Globit ku ndodhen vetë dhe familja e tyre.
Të dy prindërit e Dr Kristo Papa, MD, intelektualë të mirënjohur të fushës së veterinarisë në Vlorë e më gjerë, Pavllo dhe Aurora Papa, me një ndjenjë të lartë përkushtimi, natyrisht të kujtojnë edhe skenën e filmit shqiptar „Kur hapen dyert e jetës" me fjalinë e famshme, „bisturi baba", pasi tashmë kjo „bisturi" me të cilën syri i djalit të tyre ushqeu syrin e tij që në fëmijëri, duke parë nënën dhe babain në një profesion mjekësor të bëhet një pandashmëri në rrugën e tij të madhe, që rikthen zemrat njerëzore në jetë. Por kjo është një kapitull më vete.
Dhe në këtë bisedë të shkurtër natyrisht dhe një cekje memoriale e veprës së një miku të përbashkët, Dr Nuri Dragoi, që tashmë është në amshim. Një udhë në libra, histori, kulturë dhe traditë… e pra, në disa minuta një

shishe birrë „Peja" në tryezën tonë dhe përtej Gëzuar një fiksim për një miqësi të paharruar. Faleminderit Dr Kristo që u bëmë bashkë, që na mundësove këtë takim, ku kisha nderin dhe të dhuroj romanin tim „Blirët e Pejës" një familjeje të lidhur historikisht dhe rrënjësisht me shqiptarinë. Një Kryefjalë për respektin!
E kjo thellohet në të gjitha minutat e këtij takimi të shkurtër në minuta, por të gjatë në memorje, kur ndjen se telefoni i Dr Kristos, djalit të tyre të dashur, jo vetëm që nuk pushon, por gjithnjë me një kulturë e një respekt të ndjeshëm u përgjigjet klientëve të tij dhe njerëzve që kërkojnë „derman" në këtë kohë të rrënduar me pandemi dhe me arsye të tjera shëndetësore. Dr Kristo është tashmë në këto minuta pika e lotit të gëzimit në sy të nënës dhe shkëlqimi i ndjeshëm në sytë e babait. E ndjejmë dhe urojmë me njëri-tjetrin për brezat që të ngjajnë, të shkojnë më shumë përtej asaj, „bëmë baba të të ngjaj!".

# SKELA "JET SCAFOLDING" CILËSI, PROFESIONALIZËM, GARANCI

Skela "Jet Scafolding" tregon gjithnjë e më shumë përkujdesje në të tre elemntët e saj të suksesit. Themelet e mira janë thelbësore. Shpesh kornizat e skelave kërkojnë më shumë pllaka bazë të thjeshta për të kryer dhe përhapur në mënyrë të sigurt ngarkesën. Skela "Jet Scafolding" përdor pllaka bazë në sipërfaqe të betonit. Për sipërfaqet si trotuaret ose pllakat bazë të asfaltit janë të nevojshme. Për sipërfaqet më të buta ose më të dyshimta përdor tabela të vetme, nën një standard të vetëm, një tabelë e vetme duhet të jetë së paku 1.000 centimetra katrorë (160 in2) pa një dimension më të vogël se 220 milimetra, trashësia duhet të jetë së paku 35 milimetra (1.4 in). Për skelat e ngarkesës më të rënda mund të kërkohet shumë më tepër elementë të betonit të vendosura në beton. Në hapat e pabarabartë të terrenit që priten për pllakat bazë, rekomandohet një madhësi minimale e hapit prej rreth 450 milimetra (18 in). Një platformë pune kërkon që elementë të tjerë të jenë të sigurt. Ata duhet të jenë të ngushtë, të kenë binarët me mburojë të dyfishtë dhe të gishtin dhe të ndalojnë dërrasat. Duhet gjithashtu të sigurohet qasje e sigurt dhe e sigurt.

Komponentët themelorë të skela "Jet Scafolding" janë tubat, bashkuesit dhe dërrasat. Tuba zakonisht bëhen prej çeliku ose alumini; megjithëse ka skela të përbërë që përdor tuba të fibrave të qelqit të mbështjella me filamente në një matricë najloni ose poliestër, për shkak të kostos së lartë të tubit të përbërë, zakonisht përdoret vetëm kur ekziston rreziku nga kabllot elektrike që nuk mund të izolohen. Nëse janë çeliku, ato janë ose "të zeza" ose galvanizuar. Tubat vijnë në një sërë gjërash dhe një diametër standard prej 48.3 mm. (1,5 tubacione NPS). Dallimi kryesor midis dy llojeve të tubave metalik është pesha më e ulët e tubave të aluminit (1.7 kg / m në krahasim me 4.4 kg / m). Megjithatë ato janë më fleksibile dhe kanë një rezistencë më të ulët ndaj stresit. Tuba zakonisht blihen në gjatësi 6.3 m dhe pastaj mund të priten në madhësi të caktuara tipike. Shumica e kompanive të mëdha do t'i shesin tubat e tyre me emrin dhe adresën e tyre për të penguar vjedhjen. Bordet ofrojnë një sipërfaqe pune për përdoruesit e tribunave. Ata janë dru të kalitur dhe vijnë në tre trashësi (38 mm (e zakonshme), 50 mm dhe 63 mm) janë një gjerësi standarde (225 mm) dhe janë një gjatësi maksimale prej 3.9 m. Mbërritjet e tabelës mbrohen me pllaka metalike të quajtura pranga ose ndonjëherë pllaka gozhdë, të cilat shpesh e kanë vulosur emrin e kompanisë në to. Dyllat e tribunave të drurit në Britani të Madhe duhet të jenë në përputhje me kërkesat e BS 2482. Po ashtu, përdoret edhe stolisje druri, çeliku ose alumini, si dhe pllaka të laminuara. Përveç tabelave për platformën e punës, ekzistojnë bordet e vetme të cilat vendosen nën skelë nëse sipërfaqja është e butë ose që dyshohet ndryshe, megjithëse mund të përdoren edhe bordet e zakonshme. Një tjetër zgjidhje, e quajtur skatepad, është bërë nga një bazë gome me një pllakë bazë të formuar brenda; këto janë të dëshirueshme për përdorim në tokë të pabarabartë pasi ato përshtaten, ndërsa bordet e vetme mund të ndahen dhe duhet të zëvendësohen. Skela, e quajtur edhe skelet, është një strukturë e përkohshme e përdorur për të mbështetur ekuipazhin e punës dhe materialet për të ndihmuar në ndërtimin, mirëmbajtjen dhe riparimin e ndërtesave, urave dhe të gjitha strukturave të tjera të bëra nga njeriu. Skelat janë përdorur gjerësisht në vend për të pasur akses në lartësitë dhe zonat që përndryshe do të ishin të vështira për t'u arritur.

JET
SCAFFOLDING
LTD

Jet Scaffolding
Unit 212 Flexspace
5 Elstree Way Borehamwood
London
WD6 1SF

Tel: 0192 351 8933
Mob: 077 3874 0018
E-mail: info@jetscaffolding.com

**"Skela Jet" është e bazuar
në Watford, Hertfordshire dhe mbulon
të gjitha zonat në Londër.**

# NJË SFOND, QË PO MERR PËRMASA GJITHNJË E MË TË NDËRLIKUARA

Do të ishte marrëzi të pohosh se poetët modernë arrijnë ta mbajnë veten aq mirë të informuar mbi teoritë më të fundit shkencore, sa të mund t'i përvetësojnë ato dhe t'i shndërrojnë në poezi, por do të ishte po aq marrëzi të mbash mendimin, se ata mund të mbeten të paprekur nga këto konceptime të reja për njeriun dhe universin, dhe megjithatë jo gjithnjë, kanë ndonjë gjë të vlefshme për të na thënë.

Dikush mund të këmbëngulë që poetët, duke qenë të ndjeshëm ndaj ndryshimeve të mendimit që kanë të bëjnë me njeriun në lidhje me mjedisin e tij, (sidomos kur janë tashmë të ndikuar nga hapësira, vendi dhe koha, emigrimi, po aq nga kushte, mosha, lëvizja e ekonomia) vështirë se mund të ndihmojnë vetveten.

Ata duhet të jenë në arsyen e tyre, jo thjesht në moshën e tyre, natyrisht kjo s'ka të bëjë me moshën fizike, e rëndësishmja mbetet që të përpiqen të pajtohen me materialin dhe situatat përreth tyre. Në një mënyrë, apo në një tjetër, shumica e poetëve në këtë studim kanë tendencë të pasqyrojnë në punën e tyre me pasigurinë e periudhës dhe ndjenjën e tyre të pasigurisë rreth një ndryshese në kohë, hapësirë dhe vend, dhe në këtë drejtim, ato u japin shprehje adekuate, relative, të ndjeshme dhe të domosdoshme ndjenjave dhe shijeve tona, sepse të gjithë po bëhen dhe të gjithë po bëhemi gjithnjë e më shumë të vetëdijshëm për kompleksitetin e botës në të cilën jetojmë, ndërsa rritemi të fokusuar në aftësinë e njeriut për të përdorur burimet e tij shkencore dhe teknike për të mirën e racës njerëzore. Nëse në thelb, subjektet e poezisë mbeten të njëjtat si gjithmonë, ato duhet të vendosen në sfond të ndryshëm të përshtaur me kohën, hapësirën e vendin, pra shkurt le të thuhet, një

sfond, që po merr përmasa gjithnjë e më të ndërlikuara, por që i shërben gjithnjë e më shumë „territorit të ri letrar të krijuesve shqiptarë", ajo që në vitet e monizmit i mungoi dhe i kushtoi shumë shkrimtarit, poetit dhe vetë letërsisë.

Është koha kur Tjetri është larg ndikimit tënd, por i papërjashtuar nga ndikimi. Ndryshe?! Ndryshe do të ndodhë të jetë një Vetë-Dashuri. E kjo pastaj do të përhap papastërti në çdo çarje të zemrës së thyer të kopshtit të letërsisë. Por e kundërta dhe dedikimi tek ndikimi dhe të ndikuarit do të mbjell lule aq të mëdha dhe të bukura, sa rrënjët e tyre do të rregullojnë të gjitha pjesët e copëtuara dhe do t'i ribëjnë përsëri të jenë së bashku. Por në fakt, disa kurrë nuk do të jenë në gjendje të shohin rrëmujën që ka qenë dikur e që nuk ikën me lehtësi. Ky ndikim nga e ndikuara ende është një sfond, që po merr përmasa gjithnjë e më të ndërlikuara.

# LE TA THEMI TË PADUKSHMEN PËR DIPLOMATIN REI GOLLI

Në disa fusha të jetës puna është voluminoze dhe e padukshme. E lodhshme, dhe askush nuk e ndjen atë lodhjen e Tjetrit. E mërzitshme, se bëhet rutinë. E „gojë-përdorur“, sepse varet nga Ligji dhe askush nuk mund ta shkelë Ligjin. E, një punë e tilllë, shpesh herë orar dhe pa orar, ditë pune e jo ditë pne, ditë pushimi, e … në raste emergejnte, natyrshëm është një punë që duhet parë me një sy tjetër. E tillë në fakt është dhe puna dhe koha e përkushtimit të Diplomatit shqiptar, Konsullit të Republikës së Shqipërisë në Londër, Rei Golli. Pakkush e di se ai nuk e ndjeu dhe nuk e ndërpreu punën e tij diplomatike dhe atë të përditshmen me kontaktet me shqiptarët e të huajt në nevojë emergjente edhe gjatë periudhës më të egër të Covid-19-të. „Një shembull mjaft pozitiv“, - të thotë Ambasadori Qirjako Qirko, teksa fjala rishtas cek punën e stafit të tij. Dhe nga ana tjetër Stafi i Ambasadës gati njëzëri thonë se ai është një nga intelektualët dhe diplomatët shqiptarë, që duhet marë në konsideratë dhe bërë shembull. Këtë e thonë dhe mjaft drejtues të Komunitetit Shqiptar në Londër. Këtë e thonë dhe mjaft njerëz të thjeshtë. Këtë e ndjen tek ata që përcillen me respekt dhe kulturë në mjediset e zyrave ku ai me një staf të vetin realizon kompletimin e duhur të mjaft kërkesave të shqiptarëve. Edhe në Dublin Konsulli Rei Golli në kuadër të Ditëve të Shërbimit Konsullor në Irlandë, të organizuara periodikisht nga Ambasada e Republikës së Shqipërisë në Londër, ishte shembulli mjaft domethënës duke i ndihmuar bashkëatdhetarët shqiptarë në Dublin që ata të jenë sa më të afërt dhe të sigurtë për të marrë shërbimet konsullore që ata kanë nevojë. (#SHKO Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme - Republika e Shqipërisë) Jo vetëm kaq, por shembulli i tij është dhe në aktivitetet e Komunitetit shqiptar, ku si Staf dhe si Ambasadë funksionojnë si një ekip i vetëm, i respektueshëm dhe mjaft të kulturuar. Në një bisedë me një nga anëtarët dhe drejtuesit e Komunitetit shqiptar, në Mbretëri të Bashkuar, tashmë Deputet i zgjedhur në Legjislaturën e re të Kuvendit të Shqipërisë, Lavdrim Krashi, natyrshëm fjalët shkojnë tek ajo që mbetet vërtet meritore, e sinqertë dhe mjaft e ndjeshme, tek përkushtimi dhe mos-përtimi në zgjidhjen e qindra e qindra kërkesave të përditshme. Ai është një figurë tashmë që gjithkush do ta mbaj mend, dhe nëse shkojmë tek ajo që na bashkon këto ditë me futbollin e Europianit 2020-të, nëse kujtojmë ekipin francez, që mbetet pretendi kryesor, dhe nuk shkojmë menjëherë tek Kante, natyrisht kemi bërë të njëjën gjë dhe për Diplomatin Golli, që ngjashëm mbetet „lojtari“ më kryesor i ekipit diplomatik të Ambasadorit, Qirjako Qirko. Ashtu sikurse me Kanten, të gjithë trajnerët do të nderoheshin dhe me Rei Gollin, të gjithë ambasadorët do të ishin krenarë dhe



të lumturuar. Për Diplomatin model, për Konsullin Rei Golli mund të flasim mjaft, e mjaft dhe asnjëherë nuk do të kishim mbaruar.

### Del në dritë një libër i ri i Timo Mërkurit

Shtëpia Botuese "Beqir Musliu" ka përgatitur për botim dhe nxjerr në dritë librin e shkrimtarit, poetit dhe kritikut shqiptar, Tmo Mërkuri me titullin mjaft domethënës, „Letërsia si shpëtim nga „Rrufetë Zeusiane“ (Rreth disa veprave letrare të krijuesve të Kosovës Lindore). Lajmi e ka bërë të ditur në rrjetin social Facebook botuesi Sabit rrustemi, një shkrimtar dhe një poet me emër në letrat shqipe. Autori i këtij libri, Timo Mërkuri për këtë botim shpehet: „Faleminderit miku dhe botuesi Sabit Rrustemi , mirenjohje redaktorit Anton Nik Berisha, respekte Shtëpisë Botuese "Beqir Musliu" miq e dashamirës për këtë botim me shkrime të mia për autorë të Kosovës Lindore.. Ndjehem i nderuar dhe teper mirënjohës për botimin e këtij libri të ri. Sidomos i angazhuar për në të ardhmen….“

### Zambaku i Ujit të Liqeneve të Dumresë

Në vitin 1981 koha e aksioneve na shpuri në Dushk të Gjyralës. Me këtë rast ndërsa shijonim jetën ndryshe të atij fshati (të ndarë në dy grupe, në të lirë dhe të kontrolluar, në fshatarë të varfër dhe të tjerë të internuar), ndjenim dhe erën e zambakëve të ujit, atyre që i kishte bërë dhuratë natyra, dhe atyre që i bënte mrekullia e duarve të skulptorit të një prej djemve të Bedri Spahiut, ose burrit të internuar të nomenklaturës komuniste, që gjithnjë shafqej me kostum të bardhë. Zambakë të tillë jo vetëm zbukurojnë ujërat e liqeve të Dumresë, por dhe qasin dhe arsyet e tyre për lidhjet e kulturave. Këto zambakë janë karakteristike më së shumti e liqenit të Seferanit. Janë shfaqur dhe në liqenet e tjera, por kohët e fundit, aty nga mesi i vitit 2018-të, zambakët e ujit janë shfaqur edhe në liqenin e Belshit duke i shtuar atij një tjetër bukuri.

### Çfarë janë për vendasit

Askush nuk ka një ide të qartë, por nëpër kohëra të tjera, nga vetë fjala emërtese e zonës Dumre, (duam-re) ka rrjedhur dhe një shenjë mitike si pasojë e lotëve të lutjes për shi në atë zonë, thuajse të thatë. E kështu ajo që thuhej dhe thuhet ndoshta shkon më tutje tek folja druhet, pra hezitohet të shkruhet. E gjitha, ndoshta ka ndodhur ngaqë zambakët e ujit në këto liqene kanë mistere të tjera, por këto struken në heshtje, kur shikohen si bukuri e radhë, që vetë natyra i ka falë.

# VILA RONEL

V.R
Bar & Restaurant

Vila Ronel Bar
& Restaurant
46 Birchington Road
London
NW6 4LJ

020 7624 1385

www.vilaronelrestaurant.co.uk
Reservation@vilaronelrestaurant.co.uk

# NUK ËSHTË VONË KURË PËR FORUMIN QYTETAR

Adolf Müller (13 maj 1916 - 22 shkurt 2005) ishte politikani gjerman i Bashkimit Demokristian (CDU) dhe ish-anëtar i Bundestagut Gjerman, që në momente të rëndësihme politike për CDU ngriti zërin e tij për Forumin Qytetar. Me këtë term nënkuptojmë thelbin politik ku teknologjia e shndërruar në një lëvizje masive të ndryshimit revolucionar, praktikisht në të katër pikat diktuese: euforia, përçarja, cilësia dhe kaosi, autoriteti i lirë dhe heqja dorë gradualisht nga strukturat klasike politike, kanë forcën e madhe shndërruese dhe bindëse në fitore. Kjo ide e tij vlente edhe për lëvizjet anti-totalitare, natyrisht me një zgjerim më të thukët të mendimit politik. Që nga ajo kohë në CDU, natyrshëm suksesi ishte në ngritje, madje më pas me një rezultat dominues, pas një epoke të errët poltike. Kështu, Müller, që si politikan u bashkua me CDU në 1945 me idenë e tij bëri mjaft efekt, madje dhe cende të tjera si Republika Çeke e përshtatën më tej këtë ide. Forumi Qytetar u kthye në një lëvizje politike në pjesën Çeke të Çekosllovakisë, themeluar gjatë Revolucionit Kadife në 1989. Lëvizja përkatëse në Sllovaki u quajt Lëvizja Publike Kundër Dhunës. Qëllimi i Forumit Qytetar ishte të bashkonte forcat disidente në Çekosllovaki dhe të përmbyste regjimin Komunist. Kështu ky Forum pati disa ngritje, ndryshime, anatemime, derisa u forca dhe u përshtat në forma të reja. Sidoqoftë, Adolf Müller me idetë e tij, kishte gjithnjë ngritje politike, ku më vonë u zgjodh në ekzekutivin shtetëror të CDU Rhineland. Müller ishte anëtar i Bundestagut Gjerman nga 1961 deri në 1987. Ai kishte hyrë gjithmonë në parlament përmes listës shtetërore të Nordrhein-Westfalen. Eksperti i politikës sociale ishte edhe Kryetar i Komitetit të Punës të Bundestag nga 1965 në 1969, gjithashtu dhe Zëvendës Kryetar i Komitetit të Punës dhe Çështjeve Sociale të Bundestag nga 1969 deri në Shtator 1981. Nga 1981 në 1987 ai ishte nënkryetar i grupit parlamentar CDU/CSU në Bundestagun gjerman. Po përse i duhet PD-së së sotme të Lulzim Bashës një rifreskim i idesë së Adolf Müller për të gjetur rrënjë të reja me idenë e një Forumi Qytetar? Kur dihet se euforia, përçarja, cilësia dhe kaosi, janë para së gjithash

dukuri që dolën edhe nga zgjedhjet për frejtuesin e PD-së, po aq dhe një stuhi që fshihet pas rezultatit të zgjedhjeve të fundit elektorale, Forumi Qytetar mbetet një domosdoshmëri dhe një rrugë e pashkelur për këtë forcë politike. Kjo hyn edhe tek mendimet që qasin lëvizjet e reja, ose të rinovuara poltike. Lëvizjet e reja politike filluan të shfaqen veçanërisht në gjysmën e dytë të shekullit të 20-të. Ata shpesh karakterizohen dhe rriten me iniciativa qytetare (p.sh. ambientalistët, duke protestuar kundër ndërtimit të atomeve të energjisë elektrike, duke shkaktuar një lëvizje mjedisore). Lëvizje të tjera të tilla janë pacifizmi, feminizmi, anti-racizmi ose lëvizja studentore. Të gjitha këto lëvizje jo-tradicionale zakonisht kanë tendencë të flasin për të gjithë brezat e tyre, ose për ata që janë të prekur në mënyrë të barabartë, qoftë të diktuar nga zhvillimi i ekonomisë, një patriark politik, ose një brez tjetër, mendimi konservator ose totalitarizmi, në një kohë kur ata përballen, jo vetëm për të shkatërruar „yllin“, por për të krijuar një koncept aktiv gjithëpërfshirës për rindërtimin e shoqërisë, politizimin, shartimin dhe pjesët e tyre zakonisht marrin formën e partive politike klasike, që pas kësaj mbeten të dallueshme vizualisht. Por duhet kujdes se kjo ndonjëherë mund ta bëjë këtë insinuatë poltike që të preferojë një lëvizje që karakterizohet nga një qëllim i vetëm (monotematik). Monotematizmi mbett pastaj më shumë problematik dhe problematika zgjerohet dhe sfumohet nga diferenca midis palëve dhe grupeve n të presionit. Këtu natyrshëm vihet në funksion jeta politike. Dihet se, jeta politike në shtetet moderne demokratike dominohet kryesisht nga organizata të specializuara që janë përshtatur ndaj konkurrencës politike. Ato mund të klasifikohen në dy kategori kryesore. E para janë partitë politike, nga të cilat zakonisht vijnë politikanët. Partitë synojnë të fitojnë pushtet ose, nën vite, të ushtrojnë fuqinë e tyre për të fituar vota në zgjedhje, për të pushtuar vendet parlamentare dhe ministrore, për të formuar një qeveri. Kategoria e dytë është presioni i grupeve, të cilat synojnë të ndikojnë në fuqinë politike, për të bërë presion mbi të. Jean Meynaud thekson se një parti politike synon të fitojë pushtet dhe ta mbajë atë, ndërsa një grup presioni është i kënaqur të veprojë ndaj liderëve politikë pa dashur të marrë vendin e tyre. Në mënyrë të ngjashme, sipas Maurice Duverger, partitë politike kërkojnë të fitojnë pushtet dhe të ekzekutojnë fuqi dhe qeverisje, ndërsa grupi i presionit vepron në fuqi, por qëndroni larg pushtetit. Në presionin e grupit, përpjektet janë për te njerëzit që janë në pushtet, por jo të sjellin në pushtet njerëzit e tyre. Për më tepër, ndryshe nga partitë politike, presioni i grupit ndodh në të gjitha regjimet politike dhe në çdo kohë. Presionet e grupeve përfaqësojnë një fenomen shumë të gjerë, i cili nuk ka nevojë të trajtohet në detaje këtu. Të paktën shkurtimisht, le të ndalemi në një nga kategoritë e diskutuara kohët e fundit të grupeve të presionit, të ashtuquajturat lëvizje të reja politike.

# "PËRVOJA" SHQIPTARE NË DIETAT E LIBRAVE TË DR. LULU HUNT PETERS

Dr. Lulu Hunt Peters, nga Los Angeles, në viin 1923, shkruajti një libër shkencor, por zbavitës, me titullin "Dieta dhe Shëndeti". Në këtë ibër ajo ka përkushtuar një kapitull për ushtrime fizike për ata që dëshirojnë të zvogëlojnë peshën e tyre trupore. Janë mjaft ushtrime të cilat ajo i bazoi në eksperiencën e saj pas dy vjetësh në Ballkan. Pra, pas gati dy vjetësh me Kryqin e Kuq Amerikan në Ballkan, ajo i shtoi mjaft librit të saj që e kishte në botim e në ribotim. Në atë kohë ajo sillte mjaft nga eksperiencat shqiptare të asaj kohe për ti vlerësuar si efikase në uljen e peshës trupore. Dr. Lulu Hunt Peters gjatë dhe pas Luftës së Parë Botërore, punoi me Kryqin e Kuq Amerikan në Ballkan, ku kontributi i saj ishte jashtëzakonisht i madh. Për këtë, për punën e saj atje, në vitin 1925, pasi Ahmet Zogu, ndërsa ishte President i Shqipërisë, themeloi Urdhrin e Skënderbeut e dekoroi atë si ndër të parat femra të huaja me mision human në Shqipëri. Në këtë kohë, Dr. Lulu Hunt Peters u shfaq me kostum shqiptar, ku memorja e fotove nga Esther Pohl Lovejoy, ishte fiksuar që në vitin 1921. kjo e shtonte akoma më shumë dëshirën të fitonte dhe përvoja shqiptare mes vështirësive të kohës. Pak nga përvoja e saj ballkanike në vijën e uljes së peshës dhe kalorive trupore, mbetet ende sipas secilistëve, të jetë efikase në mjaft gjëra edhe sot, pra të mos jetë e gabuar. Në Shqipëri, ku ishte e stacionuar pjesën më të madhe të kohës, jeta e saj ishte shumë e rëndë. Ajo shkruan për këtë periudhë se "Të gjithëve na është dashur të punojmë shumë dhe të harxhojmë shumë energji nervore. Thirrjet mjekësore nën diellin përvëlues mbi kalldrëmet e pahijshme, britmat pa shkëputje ndaj mushkave, orët e gjata në klinikat e shkatërrimit të nervave, mushkonjat e egëra, që ushqehen me gjak njerëzish, parazitët dhe insekte të tjera të patregueshme na mbajtën duke shpresuar dhe duke menduar vetëm për jetën. Por ishte një ngushëllim për mua. Me këtë punë, më intensive dhe më të mundimshme sesa kisha bërë ndonjëherë më parë, nuk do të më duhet të mbaj dietë - nuk do të duhet të shikoj peshën time - nuk do të duhet të numëroj kaloritë e mia! Oh, sa gëzim!" Në tregimin e saj dhe në përvojën e saj shqiptare të rrëfimit në këtë libër, ajo e cilëson kështu: "Ne jetuam një jetë në komunitet, dhe ne ishim atje të njohur si Kryqëzuesit e Kuq. Kishim një ushqim të thjeshtë, të konservuar kryesisht amerikan, të plotësuar me tarifën që mund të nxirrej nga Shqipëria dhe të gatuar nga një shqiptar, i cili nuk mund të mësohej se ne amerikanët nuk ishim eskimos dhe nuk na pëlqente ushqimi të notonte me dhjamë. Sidoqoftë, kjo u dha shijen e mirë Kryqtarëve të Kuq, të famshëm dhe unë hëngra tre vakte në ditë, e bindur se do të ruaj hollësinë e belit, e do ta mbaja si të vajzave të moshës së mesme dhe nuk duhet të mbaj dietë. Ne nuk kishim asnjë peshore dhe pasqyra më të mëdha se pasqyrat tona të duarve. Uniformat tona ishin të mëdha dhe të rehatshme." Dhe për të luksi i vetëm ishte ajo që linin të tjerët pas ikjes së tyre. Ja si e përshkruan ajo: "Francezët që u larguan nga Shkodra, oficerët që na lënë disa prej mobiljeve të tyre, duke përfshirë një pasqyrë të pllakave franceze me gjatësi të plotë, ishin gjërat e luksit për ne. Zakonisht kur shikoja në një pasqyrë të plotë nuk e urreja

veten aq shumë, kështu që me një farë shkalle kënaqësie të parashikuar i afrohem me vetëkënaqësi, për të marrë një reflektim në madhësinë e jetës time pas shumë muaj privimi nga ajo kënaqësi" Dhe në ato pasqyra dukej se shikonim atë që bërtitej edhe në gjuhën e fqinit të Shqipërisë, Serbit, "Bogomi!" (Serbisht - 'Për dashurinë e Allahut!'). "Kjo nuk është pasqyrë," mërmëris unë, thotë ajo. "Kjo është një nga ato gjërat muzikore që ju bëjnë të dukeni si një fotografi e Tony Sarg e Irvin Cobb." Lulu Hunt lindi në Milford, Maine në 1873 nga prindërit J. Albert dhe Alice Marsh Hunt. Ajo ndoqi Universitetin e Kalifornisë, në Berkeley në 1909, duke u diplomuar me një MD dhe më pas përfundoi Universitetin e Kalifornisë Jugore në 1911, duke u diplomuar me një A.B. Një mjeke dhe edukatore e shëndetit publik, ajo filloi praktikën në 1915 në Los Anxhelos. Ajo shkroi artikuj të përbashkët shëndetësorë për një larmi revistash dhe disa libra. Gjatë dhe pas Luftës së Parë Botërore, ajo punoi me Kryqin e Kuq në Ballkan, për të cilin asaj iu dhanë dy medalje. Iu dha medalja Shën Sara e Serbisë dhe Urdhri i Skënderbeut të Shqipërisë. Ajo vdiq në Londër në vitin 1930.

# LIGJET PËR EUROPIANËT PAS 1 KORRIK 2021

Punëdhënësit do të duhet të kontrollojnë që punëtorët nga Zona Ekonomike Evropiane (EEA) dhe Zvicra kanë të drejtë të punojnë në MB nga 1 korrik 2021.

Skema e Zgjidhjes së BE, që lejon shtetasit e EEA që ishin në MB deri në fund të vitit 2020 të zyrtarizojnë statusin e tyre, mbyllet në shumicën e aplikimeve në 30 Qershor 2021. Deri në këtë datë, shtetasit e EEA mund të paraqesin pasaportën e tyre ose letërnjoftimin kombëtar si provë e tyre e drejta për të punuar në Mbretërinë e Bashkuar. Sidoqoftë, nga 1 korriku 2021, qytetarët e EEA-së dhe anëtarët e familjes së tyre do të kenë nevojë për një status emigracioni në MB dhe nuk do të jenë më në gjendje të mbështeten në pasaportën e tyre të EEA-së ose kartën e tyre të identitetit. Në pritje të kësaj, Ministria e Brendshme e Mbretërisë së Bashkuar tani ka botuar një projekt-kod të azhurnuar të praktikës për parandalimin e punës së paligjshme (kodin e praktikës). Kodi i praktikës hyn në fuqi më 1 korrik 2021 dhe përqendrohet vetëm në regjimin e ndëshkimit civil (përgjegjësia penale për punë të paligjshme mund të lindë gjithashtu). Hasshtë botuar në formë drafti por nuk pritet të ndryshojë. Udhëzimet më të hollësishme të punëdhënësit për kontrollet e së drejtës në punë janë azhurnuar gjithashtu.

Por Udhëzimi i azhurnuar i punëdhënësit për kontrollet e së drejtës në punë thotë se masat kalimtare do të jenë në fuqi deri më 31 dhjetor 2021. Në rrethana të tilla, punëdhënësi nuk do të duhet të ndërpresë punën kur zbulon se punonjësi nuk ka aplikuar për të siguruar një status. Punëdhënësi duhet të: Këshilloj punonjësin të aplikojë në Skemën e Zgjidhjes së BE brenda 28 ditëve dhe të sigurojë një kopje të Certifikatës së tyre të Aplikimit; pasi të jetë siguruar një kopje e Certifikatës së Aplikimit, përdorni Shërbimin e Kontrollit të Punëdhënësit për të konfirmuar që ata kanë aplikuar. Nga punëdhënësi mund të kërkohet të sigurojë dëshmi për datën e fillimit të individit, duke përfshirë një kopje të kontrollit fillestar të së drejtës për punë; nëse merret një njoftim i verifikimit pozitiv, një justifikim ligjor do të sigurohet për gjashtë muaj, duke lejuar që aplikimi të përpunohet; duhet të kryhet një kontroll i përsëritur para se të skadojë Njoftimi për Verifikimin Pozitiv.

Nëse Ministria e Brendshme zbulon qytetarë të EEA-së, ose anëtarët e familjes së tyre, të cilët po punojnë pa një status sipas Skemës së Zgjidhjes së BE-së, atyre do t'u jepet një njoftim 28-ditor para se të ndërmerren veprimet. Kjo do t'u lejojë atyre mundësinë për të bërë një kërkesë të vonuar, megjithëse nuk mund të garantohet se një kërkesë e tillë do të pranohet, varësisht nga arsyet e humbjes së afatit.

# “NETËT E BEJKËS SË BARDHË”, ATY KU NIS TURIZMI KULTUROR DHE... SYRI NDRYSHE I BOTËS

Fjala “folklor” dhe konceptet ideo-estetike për të kanë lindur prej kohësh forma të ndryshme mendimesh. Me të parën në folkloristikën europiane kuptohej dhe vazhdon të kuptohet vjershëria popullore. Me të dytën janë lidhur mjaft shkolla të studimit të fakteve si ajo romantike, mitologjike, metereologjike, antropologjike etj. Duke e konsideruar folklorin si një veprimtari që u përket “popujve primitivë” dhe të “racës së ulët” ku janë shfaqur dhe mendime të egra si shfaqje “foshnjërie të ngurtësisë” dhe të “menduarit automatikisht” natyrisht dhe me aksiomat se folklori u përket popujve të paditur, analfabetëve etj., tashmë duket se kanë marë konsiderat të tjera në disa vende. Janë të parët Letonezët që kanë bërë një ndryshim të thellë, duke hyrë në të shkuarën e tyre të trazuar e duke risjellë vëmendje të reja. Për këtë një formë e vjetër letoneze e poezisë e quajtur “dainas” është bërë faktor rikthimi vëmendjeje dhe madje një arsye më shumë për të sfiduar mjaft mendime rreth formave të folklorit. Dhe ja si mund të shpjegohet me një arsyetim nga ky faktor dhe nga ky fakt.

Me kalimin e viteve, suedezët, gjermanët dhe rusët të gjithë kishin një përpjekje për të pushtuar Letoninë dhe për t’i imponuar asaj shijet e tyre të krishterimit. Sot luteranët adhurojnë kryesisht në perëndimin e vendit dhe ortodoksët rusë në lindje. Por ritualet më të thella të Letonisë janë ende të frymëzuara nga marka e saj e paganizmit e rritur në shtëpi. Ato përfshijnë ahengje të egra të solsticit veror dhe një festival kombëtar të këngëve dhe vallëzimeve çdo pesë vjet. A nuk kanë një ngjashmëri të tillë edhe shqiptarët me festat e tyre pagane në disa zona si me “Ditën e Verës” apo dhe me disa të tjera? A nuk janë shqiptarët e ndjeshëm dhe mjaft strikt me Polifoninë? Dhe fakti që këto ditë Piluri e mbajti gjallë një festival të tillë për këtë pasuri të madhe tregon se folklori vazhdon të mbetet një arsye më shumë në sytë e kulturave.

Por, le të kthehemi tek Letonia tek himnet e besimit të saj që janë tashmë në vëmendjen ndryshe. Himnet e këtij besimi parahistorik janë poezi popullore, tipikisht katër rreshta, që sikurse e cituam janë të quajtura dainas. Falë Krisjanis Barons, një folklorist i cili inkurajoi Letonët të shënonin katërvjeçare të tilla në shekujt 19 dhe në fillim të shekujve 20, mbi një milion prej tyre janë në skedarë në bibliotekën kombëtare në Riga, kryeqytet. Kështu Riga, Kryeqyteti Evropian i Kulturës në vitin 2014, shumëfishoi ngjarjet dhe festivalet mbi kulturën Letoneze. Ky status dallues u mundësoi banorëve të qytetit të shprehen, madje edhe të këndojnë, në emër të folklorit kombëtar. Në të vërtetë, Letonët shpesh (dhe me të drejtë) konsiderohen si njerëz këngëtarë. Dhe aty pothuajse një pjesë e gjerë e Botës mësoi se ashtu si haikus në Japoni, Letonia ka formën e saj poetike: dainas, të cilat ose këndohen, ose recitohen gjatë festivaleve të njerëzve. Këto tekste unifikuese janë jetike për të kuptuar ndërtimin e identitetit letonisht. Ato janë më shumë se një ushtrim i thjeshtë në stil: dainas luanin dhe ende luajnë një rol të rëndësishëm në historinë e vendit.

Nëqoftëse u hedhim me këtë rast një sy krijimeve të mëdha popullore të shumë popujve, do të mbetemi të mahnitur përpara mendimeve dhe dukurive shumë të ralla që kanë krijuar popujt. Janë mendimtarë shumë të mëdhenj, poemat e njohura si “Iliada”, “Qor Ogliu”, “Edat” “Kalevala” dhe “Nibelugden”, rapsoditë për të bëmet e “Mujit dhe Halilit”, lirikat erotike, këngët historike, janë jo vetëm shprehje e një pasurie të madhe, por edhe një aftësie të mrekullueshme artistike. Mjaft popuj i shfrytëzojnë këto sot për “turizmin kulturor folklorik”, aq të domosdoshëm edhe pas kësaj pandemie vrastare.

Duhet theksuar se meloditë shqiptare romantike të fyejve, kabatë, iso-polifonia e të tjera tregojnë mnë mënyrë bindëse se ato nuk janë aspak krijime të njerëzve të paditur, të analfabetëve, po të një kolektivi të pasur me ndjenja dhe kulturë të lartë, të bartësve dhe improvizatorëve të një talenti të pakrahasueshëm, pavarësisht se në të kaluarën e errët masat popullore nuk dinin as të shkruanin, as të këndonin, as të njihnin dhe rregullat e tyre, që sot janë ndryshe, janë një arsye më shumë të shkundin pluhurat dhe ndasitë kulturore që i ka mbuluar politika.

Tashmë është kapëryer edhe fakti si konsideratë e vetme e krijimit imagjinar dhe me faktin letonez, ku Daina, kjo formë e shkurtër e poezisë që ndan shumë gjëra të përbashkëta me Haikun po bën vëmendje, natyrisht duhet parë me një sy tjetër edhe nga Akademia e Shkencave të Shqipërisë dhe më gjerë. Dihet se dainat janë ndikuar më shumë edhe nga traditat e këngës popullore Evropiane, ku kuptojmë dhe arsyen e madhe të lidhjeve kulturore edhe në këtë kohë të domosdoshme për sa më shumë lidhje të tilla.

Edhe pse zanafilla e dainas (të cilat transmetohen oralisht nga brezi në brez) është akoma e papërcaktuar, sidoqoftë, dainat e para mësohet se u shkruan në shekullin XVI, dhe ato tashmë kishin formën e tyre përfundimtare në atë kohë: shumica e madhe ishte e përbërë nga katërkëndësha trokaike ose daktilike të shkruara në Letonisht. Ata trajtuan tema të ndryshme duke filluar nga mitologjia Letoneze te jeta e përditshme. Për shkak të vazhdimësisë së zhanrit përmes epokave në territorin Letonez, (të gjitha këto pavarësisht shekujve të okupimit dhe shtypjes), dainas janë mënyra kryesore e transmetimit të kulturës Letoneze dhe një nga piketat në ndërtimin e identitetit.

Për më tepër, pak para se Letonia të bëhej e pavarur në 1991, Letonët shfrytëzuan këto daina si një armë diplomatike gjatë “Revolucionit të Këndimit”. Turma të tëra kënduan përgjatë atyre këngëve të përjetshme, tepër simbolike. Për këto arsye të shumta, forma e daina është regjistruar në UNESCO’s Memories of the World që nga viti 2001.

A nuk duhet të bëjë të njëtën gjë edhe Shqipëria me institucionet dhe fondet e saj kulturore e kërkimore shkencore, që shpeshherë nuk dihet se ku po shkojnë? Le të këndojmë bashkë jug e veri format tona të bukura e le të sjellim vëmendjen e të Tjerëve. Festivali i II-të Folklorik Pilur kishte një meritë të jashtëzakonshme për këtë në këto ditë të ngarkuara me “lodhje” të tjera. “Netët e Bejkës së Bardhë” kishin dhe kanë mjaft arsye të mbeten më lart, më gjatë dhe më dukshëm në hartë, në hartën e Botës Kulturore.

# BIR, NDIZ ZJARRIN TËND!

Është një fragment. Pos tij vijon e qeshura dhe… Pak a shumë është i tillë. Dy zonja kalojnë pranë aktorit të humorit Theofil Haxhijani dhe ngulin sytë tek hunda e tij e gjatë. Aktori me një sens të thjeshtë, tepër domethënës, delikat por gjithë takt u kthehet: „Mos Ju pengon gjë hunda ime?!“ E ndërsa e qeshura konsumohet mjediseve të tjera, ajo që ka mbetur pos frazës që ende të bën për të qeshur është një filozofi më vete. Mjafton vetëm kaq. Mjafton të bëhet zbërthimi i saj dhe „Mos Ju pengon gjë hunda ime?!“ të kuptohet në tërë aftësitë e saj komunikuese. E gjitha thuajse duket se ndodhet tek libri i tij autobiografik „Një mendje, hiç mendje“, por është e pamundur të besohet kështu, pasi gjuha e trupit dhe e mimikës së këtij aktori artist me vlera të padiskutueshme fliste, flet dhe do të flasë akoma më shumë se sa teksti. E tillë ka qenë që në fillesën e saj, kur ai u gjend përpara konkurrencës në rritje të aktorëve ku nis jetën artistike, ku emrat e aktorëve, Jorgo Nano, Lekë Mosi, Myfit Brajo, Illo Martiko, madje dhe Violeta Cari (Haxhijani), bshkëshortja e tij dhe shoqja më e mirë e udhës së tij artistike, ishin jo thjesht përditësi e angazhim artistik.

Shpeshherë i gjendur në krah të regjisorit të talentuar, Thoma Milaj, ajo që pasohet nga teksti dhe „body-language“ (gjuha e trupit) kanë një kuptim më të gjerë në qasjen e humorit që përcillte vetë prezenca dhe statura e aktorit, po aq dhe ajo që ai enkas e përdorte si armën e fundit të tij për të angazhuar të qeshurën masive, pra atë element jetik të ushqimit të humorit artistik. Me këtë kontekst dhe profil memorjesh ikona e Estradës së Sarandës, Theofil Haxhijani, i mbërthen tashmë 82 vitet e jetës së tij në një grusht metaforash humori, që mbeten buqetë e pavdekshme për brezat që ai i bëri të ndjehen mirë, të qeshin e të mbajnë jetën larg halleve dhe përditësive të kohërave. Ai ende është „rinosh“ në qasjen memoriale, dhe kështu mbetet ajo që ne vazhdojmë të ndjejmë për udhën e tij artitike.

Theofil Haxhijani lindi në qytetin e Delvinës, më 14 nëntor 1939 dhe për gati 30 vjet punoi si aktor profesionist në estradën profesioniste të Sarandës. Spikati si aktor i humorit në Lëvizjen Teatrore Amatore të Delvinës dhe për aftësitë e tij u tërhoq në Estradën Profesioniste te Sarandës, ne shtator te vitit 1965. U martua me aktoren Violeta Cari Haxhijani, me të cilën interpretoi së bashku në skenën e kësaj estrade shumë role, sidomos kuplete, parody, skeçe të muzikuara, komedi muzikore etj. Ka realizuar mbi 200 role, kryesisht në gjinitë e shkurtra të humorit,, por u bë i njohur posaçërisht si kupletist e parodist me zërin e tij të ngrohtë, melodioz, me sensin ironik e sarkastik si dhe me mimikën karakterizuese. Krahas roleve në llojet e shkurtra të dramaturgjisë si skeçe, dialogje, monologje, kuplete etj., luajti edhe role në komedi.

Ai u dallua me rolin Sokrati, te komedia „Me plot deshirë“, 1978, ku loja e tij e bëri që Sokrati të ishte një nga figurat më të arrira të tij. Në këtë rol tërhoqi vëmendjen shpotia ndaj zyrtarëve të shkëputur nga jeta, sikurse edhe dhuntia për të luajtur bukur e me korrektesë në partin vokal-muzikor. Më pas interpretoi tenente Moretin në komedinë muzikore „Alarm me postekomandë“ (1981) teë Enver Isufit. Pas vitit 1991 emigroi në Greqi. Në vitin 1970 iu dha Urdhri “Naim Frashëri” i Klasit të Tretë. Më 1978 u pranua si anëtar i Lidhjes së Shkrimtarëve dhe Artistëve të Shqipërisë. Në vitin 1979 mori titullin “Artist i Merituar”, ndërsa në muajin nëntor 2014 iu dha titulli “Mjeshtër i Madh”.

Theofil Haxhijani ka interpretuar edhe ne disa filma ku permendim “Udhëtim në pranverë” – (1975); “Nga mesi i errësirës” – (1978);“Pranverë në Gjirokastër” – (1978); “Historiani dhe kameleoni” – (1989) etj. Natyrisht nuk ka si të mos e kuptosh sensin e humorit tek polici i “Udhëtim në pranverë”, apo tek roli i Zeqos tek “Nga mesi i errësirës”, edhe pse teksti pret sublimen e gjuhës së aktorit. Por ajo që mbetet e mrekullueshme, tipike, e thënë qartë dhe shkurt si „alla-theofiliane“ janë komeditë me një e shumë akte, vodevilet gazmore e deri tek operetat e plota), ku shihet plasticiteti i qenësishëm, mimika e nevojshme dhe aktrimi jetik, natyral, domethënës që mbërthen talentin e vet, po aq edhe këngëtarin melodioz, paraodistin e kupletistin brilant, atë që në thelb e në heshtje të gjithë në Sarandë e parnojnë si themelin e një institucioni, që nuk mbetet vetëm tek rolet, por tek mjeshtëria që i dallon ato.

Për këtë e mjaft gjëra të tjera, që në takimin tim me të në Sarandë, pas shumë vitesh në kuadrin e Triremës Joniane, të organizuar mrekullisht nga i pavdekshmi, poeti i Jugut, Agim Mato, „Mjeshtër i Madh“ ndjeva të lëvrinin domosdoshmërisht vargjet e mëposhtme, natyrisht me një diagramë artistike për të:

**BUZËQESHJE**
**Aktorit të humorit Theofil Haxhijani**

Ajo që qeshëm ishte velë e ngrehur mbi erërat e çelikut
shkëlqim i detyrueshëm i stërkalave të Jonit
kristal pamja e Delvinës në qendër të zemrës
nxitimi i shirave të ngadalta nga burimi i kuarcuar
për të lënë fjalët mbi një personazh të lumtur të shenjtë
larg nga barku i grifshës
lindur në ato monumente të kthyera në kujtesën tonë
një jehonë
të pafajshmit të lindur nga korraca e një kohe
i shuan ëndërrat nga etja natyrore
duke lejuar një qasje
si pluhur zjarri në rritje nga dihamat e kaluara gjatë natës
BUZËQESHJE.

# KUR BUKURIA DHE ESTETIKA SHQIPTARE KISHTE KRYEFJALË TË „ENIGMËS“ GJERMANE TË PAPËRSËRITSHMEN

*Nga Liza Laska*

Periudha e viteve 1935-38 ishte një udhëtim i shpejtë për fotografinë. Ky udhëtim u shtua dhe u përshpejtua nga konkurrenca në kërkim të përsosjes së ngjyrave. Kështu fotografia me këtë shpejtësi pikëtakoi dhe diktoi mjaft surpriza, që ende mbahen dhe diktohen si të avancuara për kohën kur ata u shfaqën. Shpejtësia e ngjyrave, përsosmëria e tyre në vazhdim zgjoi dhe konkurrencën. Në këtë konkurrencë u vunë dhe mediat, sidomos revistat e asaj kohe. Revista gjermane „Die Woche“ („Java“) ishte ndër të parat që u përfshi në këtë konkurrencë të qasjes së fotografive me ngjyra. Kopertinat e saj tashmë kishin në plan të parë ngjyra dhe pamje të reja, figura të panjohura e të ekspozuara mirë artistikisht. Gjithnjë kërkohej një botë e re, një botë e panjohur. Shkaku ishte jo thjesht ekspozimi, por dhe fitimi i besimit të kompanive paqëndrueshme. Si pasojë u krijua një metodë përpunimi disi e thjeshtuar. Në fakt ishte ajo që duhej vazhduar më tej, pasi në vitin 1936, „Agfa“ gjermane konkuronte me filmin e saj integral të trefishtë, „Agfacolor Neu“, i cili ishte përgjithësisht i ngjashëm me „Kodachrome“, por kishte një avantazh të rëndësishëm. „Agfa“ kishte gjetur një mënyrë për të përfshirë bashkuesit e ngjyrave në shtresat e emulsionit gjatë prodhimit, duke lejuar të tre shtresat të zhvillohen në të njëjtën kohë dhe duke thjeshtuar shumë përpunimin. Kjo ishte ndikuar nga puna e amerikanit Eastman Kodak, që ishte ndjerë në vitin 1935, si një sukses i jashtëzakonshëm. Ishte një punë që kërkonte bashkëpunim të gjerë e po aq dhe konkurrencë të vazhdueshme.

Kështu udha e kërkimeve dhe eksperimenteve me ngjyrat e fotografisë që në vitin 1840 kishte tashmë një pikë të rëndësishme. Në këtë pikë të konkurrencës fotografike të asaj kohe.

Ishte viti 1938. Në këtë vit, u prezantua një fletë filmi në madhësi të ndryshme për fotografë profesionistë. Me të u bënë disa ndryshime për të kuruar problemet e hershme me ngjyra të media, dhe sidomos revistat e kishin fjalën e parë. Kryefjalë e kopertinave u bë femra. Edhe në kopertinën e „Die Woche“ („Java“) në vitin 1938 protagoniste u bë Liza Laska. Ajo shfaqet me sytë e saj bojëqielli, si Deti Adriatik, që lag Vlorën, ku ajo kishte lindur më 6 shkurt të vitit 1926. Fustani i saj plot dekoracione dhe ngjyra të ëmbla roze të butë, të gërshetuara në mëndafshin e copës dhe në ngjyrat e brezores bojëqielli me të kuqe e të verdhë, natyrshëm qëndrojnë me një vlerë aestetike të gërshetuar të bukurisë dhe pasurisë që mbart në kokën e zbukuruar me ar, po aq dhe në duar e në qafë. Stolitë e arta dhe të argjendta, vathët e plota, monedha të arta, janë një arsye më shumë për të shtuar më shumë tek ajo që shoqëron kopertinën: „Në këtë broshurë: Kush e njeh gruan shqiptare?“.

Kjo e fundit është dhe vetë preambula sekrete dhe e fshëhtë që zbulon konkurencën e asaj kohe, në luftën me ngjyrat e fotografisë. Tashmë ajo nuk është më enigmë, është një arsye më shumë edhe për faktin dhe fatin e fotografisë me ngjyra, edhe për bukurinë e padiksutueshme të femrës shqiptare, dhe pse quhej e panjohur. Kjo femër shqiptare, një nga protagonistet më të ndjeshme femërore të shekullit XX natyrisht më vonë do të bëhej një aktore me mjaft role në filma dhe në teatër, dhe do të mbante titullin “Artiste e merituar”. Ajo u vu në qendër të vëmendjes së vitit 1938-të, kur fotot e femrave me ëmër kishin bërë vendin e caktuar në atë konkurencë globale të asaj kohe.

Ishte fotoja e imazhi me ngjyra i aktores Maria Babanova që solli dhe një stigmë të re. Dramaturgu Aleksej Arbuzov dhe aktorja Maria Babanova u treguan grave sovjetike se jeta nuk ka të bëjë me martesën si një synim përfundimtar, përkundrazi, ka të bëjë me të qenit me atë që ata janë. Sakaq në tërë aspektin e ngjyrave yjet femërore vetëm diktonin atë që duhej dhe pritej të realizohej.

U shfaqën me ngjyra në vitin 1938 Barbara Stanwyck, Stella Stevens. Barbara Stanwyck ishte një aktore, modele dhe valltare Amerikane. Një yll i skenës, filmit dhe televizionit, ajo ishte e njohur gjatë karrierës së saj 60-vjeçare si një profesioniste e përkryer dhe e gjithanshme për praninë e saj të fortë, realiste në ekran. Stella Stevens ishte gjithashtu një aktore amerikane e filmit, televizionit dhe skenës. Po në këtë priudhë emra të tjerë u bënë arsyeja e kësaj konkurence që kërkonte vendin e duhur e të avancuar të bukurisë femërore mes ngjyrave në fotografi. Femra shqiptare, padiskutim hyri në këtë konkurencë me një pamje të gjallë, me realitetin e krenarinë e bukurisë shqiptare, dhe kështu atë e shënoi në realitet bukuria e Liza Laska dhe arti e estetika e veshjeve shqiptare. Pra ishte viti 1938. ishte koha kur bukuria dhe estetika shqiptare kishte kryefjalë të „enigmës“ së medias gjermane të papërsëritshmen Liza Laska, këtë simbolikë të ngjyrës dhe koloritit konkurues femëror të asaj kohe në fotografi.

# NË ATË MOMENT NE ISHIM NJË

A jeni zëri i mendjes suaj? – rrëshqiti fletën e parë dhe tështima kapërceu sinjalin e frikës.

-Shëndet! Pa të tjerat rregullohen, le ta firosim këtë flamë. Le të na hapen sytë..., - ishte përgjigjja me rënien e gjethes së parë në stinë tjetër. Ndërkohë shiu kishte pusullën e vet. Hidhej e sillej mbi mal. E mali e priste me krahë të hapura, edhe pse dyshimi vinte nga lart, pikërisht atje Lart, shiu kishte ndërruar takt. Ishte ndryshe. Ndryshe binte shiu në majë. E sakaq dukej se kjo ishte e shkuar…

Pas së shkuarës, pra, pas rënies së shiut mali thirri emrin e radhës, duke e joshur me pika shiu që shkëlqenin gjithnjë, dhe që ledhatonin aq butë nën shoqërinë e rrezeve të ndriçuara nga dielli. Dukej sikur e gjitha ishte lëshuar si ato faturat marramendëse, të harruara e të mbufatura, që vijnë nën derë si gjethet e stinës së rënies së gjetheve, jo të kësaj që thuhej se ishte stina e luleve. E kush e kishte parë drejt e në sy këtë stinë?

Të lëshuara gjerë e gjatë, si krahë të bekuara nënash, pemët, vetëm ato e mbronin trupin e tij, nga ajo që ishte sipër gjetheve të tyre. E ai ngjitej. Vazhdonte të ikte në lartësi. Ngjitej. E shihte se tashmë askush nuk pyeste, as për ato pika që kishin mbushur Tokën pellg, as për ato që mbanin në kurrizin e tyre pemët e tilla, gati të shtrira e të mpira.

Por, ndërsa arriti atje, pikërisht në atë mal të lartë, humbi në mjegull. Lartësia ishte maskuar e tëra. Diku kishte veshur bizhame larushe, diku çarçafë të bardhë, diku kanatiere e diku lëmisha të holla e të mëndafshta, ku reklamonin truptha të hollë e të gjatë në modë. Kokërza të ngritura, buzë të fryra e të ndezura flakë. Kërkoi me duar e me këmbë, se sytë i kishte thuajse të zënë, duke u përshkuar prekjen, aq sa mund ta quaje të tillë në atë distancë verbërie, madje diku edhe nëpër luginë dhe në mendjen e tij e kapërcente prekjen si narciziste.

Nuk donte ta besonte ringjalljen e Narcizit në atë lartësi. Ishte mjaft lart, sikurse e kishte të qartë. Dhe atje ishte poshtë… Poshtë…

Dhe nga poshtë këmbëve të tij u ngrit si avull vetë dëshira për t'u takuar me diellin. Ishte më në fund diçka që i turrej, e prekte, e ngashërrente, e ndjente, e ishte më në fund, pra, më në fund duke e puthur në faqe. E puthte dhe e puthte me një kënaqësi të madhe.

Atëherë vetëm atëherë, ai u ndje, u shkund dhe bërtiti: „Më në fund jam në shtëpi, shpirti im është i lirë tani mund të mbështes kokën për të fjetur!"

-Të priftë e mbara!- rrëshqiti fletën e dytë dhe Fryma u kopsit duke bërë detyrën e lodhjes.

-Ja edhe lodhja u ndje. U bë ajo që bën vetëm lodhja.- E fletët shkuan në palitjen e tyre të përshpejtuar. Ishte duke shfletuar papushim. Papushim…

Në fund e pa se kishin mbetur pak fletë. Ndoshta aq pak …, aq pak fletë. U shkund në atë avulli, dhe qeshi me të madhe, qeshi, duke e stër-pjekur të qeshurën me një maturi të madhe.

E filloi të fliste. E filloi të pyeste…

-Valët e baticës?

-Ka raste kur shikoj rrugën tënde dhe …

-Skica e fytyrës tuaj është lumineshente.

-Hyri nga sytë tuaj?

-Po mbytem.

-Thellë?!

-Duke më konsumuar e tëra. Ah kjo, ah kjo si …, si valët e baticës. Më tërhiq në thellësitë e universit. Ndërsa vetëdija ime zbret në boshllëk. A mund të të pyes a kam nën kokë ndonjë jastëk?

-Diplomatike, kjo pyetje. Megjithatë delikate.

-Kujdesu për sytë, dhe… butësisht kthehu përsëri në tokë!

-Ku e kuptoj këtë? Ku e kuptoj, ku e ndjej këtë zë?

-Në atë moment ne ishim një. Në atë moment ne ishim një. Në atë moment ne ishim një!

# PËRSE E ZBEHIN VOLUMIN E PËRKUSHTIMIT TË BASHËS

*Nga Gazmend Cufaj*

Po të shikosh dhe ndjekësh emisionet televizive shqiptare, të dëgjosh opinionistët, pastaj të lexosh shkrimet e mjaft autorëve, kritikë e jo-kritikë, të gjithë e pranojnë se Kryetari i PD-së, Lulzim Basha është europian, Perëndimor dhe mjaft modern në sfidën politike. E thënë se është i kualifikuar, i gatshëm të ndryshojë sistemin e kalbur poltik në Shqipëri, i denjë për të luftuar dhe bërë Drejtësi, por nuk e thonë më të rrëndësishmen, atë që mbetet tek Volumi i i Përkushtimit dhe Punës, që ai bëri për të rindërtuar e ringritur një parti të zënë nga karieristët dhe njerëzit me dyshime në rrjedhat e Demokracisë.

A bëhet kjo në pak kohë?

Natyrisht që jo. Lulzim Basha ka shumë e mjaft më tepër për të bërë. Prandaj rizgjedhja e tij në krye të PD-së është mjaft efikase, mjaft shpresëdhënëse. Gjithnjë në Grupseksionin tim që unë drejtoj kam mbështetur dhe mbëtes Lulzim Bashën, se e besoj volumin e përkushtimit të tij.

Ndërsa totalitarizmi qeveritar përparon, dhe po bëhet gangrenë e uzurpimit të pushteteve, po bëhet e qartë se çështjet të cilat dikur ishin të kufizuara në politikën kombëtare tani janë çështje me ndikim dhe shqetësim më i madh, edhe pse poltikanët dhe diplomatët e shohin nga një kënd tjetër. Pandemitë, sëmundjet ngjitëse të reja dhe kërcënimet e bioterrorizmit tani kuptohen qartë si kërcënime të drejtpërdrejta ndaj sigurisë kombëtare dhe globale, ndaj ndoshta syri real ndaj asaj që cituam shkon në një kënd qorr. Rëndësia strategjike e opozitës, dhe Liderit të saj nuk ka ndryshuar, pasi ajo mbetet prioriteti i demokracisë, por ajo është bërë një pjesë integrale e lënë pas dore pos agjendave ekonomike, gjeopolitike, të sigurisë dhe drejtësisë sociale, duke përfshirë të drejtat e njeriut dhe politikën e brendshme-të jashtme, ndër agjendat e tjera në zhvillim. Politikat në zonat jashtë sektorit të Opozitës, të tilla si korrupsioni qeveritar dhe krimi ekonomik, tani ndoshta do të kenë më shumë vëmendje edhe nga ata ndërkombëtarë që ishin dhe mbeten dualë.

Në një kontekst global në ndryshim

Në një kontekst global në ndryshim, rizgjedhja e Bashës, jo më shumë e më pak përfaqëson tashmë një shpresë që mund të konsiderohet një efekt i rëndësishëm për negociata mbi çështjet e politikës globale që formësojnë dhe ndikojnë në mjedisin shqiptar e më gjerë, pasi ai është një nga njohësit më të mirë edhe të kësaj fushe strategjike për shqiptarët. Kjo edhe mjaft të tjera tregojnë dhe flasin mjaft pse kundërshtarë dhe të tjerë kërkojnë të zbehin volumin e përkushtimit të Bashës.

E fundit për nga radha dhe rëndësia është dhe fjalia, „Rikthehet Basha në sulm kundër Qeverisë?!“ Nuk mund të kuptohet ndryshe, vetëm në radhën e gjërave që duan të mos e cekin vlerën thelbësore të liderit demokrat, atë që ai bëri, bën dhe vazhdojë të mbajë një PD në kushtet e sotme, që të gjithë e dinë, si ka përfunduar për arsye që dihen, mbahen të pafolura e që mjaft herë janë dhe debatuese. Por, pyetja qëndron gjithnjë në themelin e duhur: Përse e zbehin volumin e përkushtimit të Bashës?

# TË RIBLESH TË GJITHA MEMORJET

Shtëpia ku unë u rrita, është bërë një me shtëpinë e përjetshme të Gjyshit. Unë mezi perceptoj midis shtëpisë dhe ndenjës së gjyshit tim. Kjo vështirësohet. Zbehet, grimohet, zvetënohet. Të dy, objekti dhe subjekti, kanë hequr dorë nga hija e manave të bardha, dhe atyre dy të tjerave me ngjyra larushe, të zeza dhe të kuqe. Të dy janë lodhur nga ikjet masive. Të dy janë cfilitur nga braktisjet e këtyre anëve, e troshave të viteve. Të dy janë fryrë, po aq dhe nga frymërat që ecin vetëm brenda skallmave të tyre. Tek të dy kanë mbetur ndoshta sytë varur diku në ndonjë pikë. Ndoshta në atë pikë ku manat e fundit gëlltiteshin nga zogjtë pafund të verës. Diku... diku ... diku... Vetëm unë ndjej disi ndryshe prezencën time të dikurshme. Jam ende fëmijë. Jam ende duke u rrëzuar e ngritur në ato dysheme. Duke u zhgarravitur sysh e thonjsh të buta në ato mure. Jam ende një hije e vockël nën ato mana të shijshme. Habitshëm, përditë e përnatë jam në shtëpi. Duke qenë aty, ashtu ngulthmi rimarë drejtimin nëpër korridor. Eci dhe nëpër kuzhinë, dhe tani unë jam duke zhurmuar nëpër dysheme. Nuk ka njeri! Nuk ka njeri! Nuk ndodhet askush. Fshij sytë dhe e kuptoj këtë togfjalësh që do të thotë "Largohu nga mahija ime!" Të largohem? Të iki? Unë që kam çelësin e të gjithë këtyre kujtimeve... unë të largohem?! E habitshme. E mistershme. E dhimbshme. Dhe bëj moskuptimin, mosbindësin. Eci, ashtu lehtazi, me përkujdesjen më të madhe për zhurmën. Bëj më tej. Mundohem të bëj hapa të kujdesshëm andej nga kovçeku i madh i shtëpisë, atë që stërgjyshi e pati sjellë nga larg të gdhendur e të zbukuruar për merak. Është nga dërrasat e Lumit Kalamai. Është me dërrasa çami. Dhe ngul sytë diku. Mendova se stolitë e Nënës sime mund të ishin atje, por as nuk kuptohej se çfarë ishte bërë me ta. Më theu zemrën kur e pashë atë që kurë s'e kisha parë. Ishte tashmë thjesht një rrangallë pa kujtime. Një sënduk i flakur, i brakstisur, i mëkatur. Doja të kisha përsëri kujtime, doja të ribleja të gjitha memorjet. Dhe sikurse ndodh në të tilla raste, Njeriu i asaj dynjaje, në zgullimën e tij kërkon të hapë banka e të shkruajë e të firmosë çeqe, për të mos thënë dengje e dengje me para nga shtete e vende të ndryshme. Ishte kot. As edhe të gjitha paratë në botë nuk mund t'i blinin kujtimet. Magjia me të cilën isha rritur me të kishte vdekur. Nuk kisha më fëmijëri, që të binte mbi zhardhokë të bardhë, që vinin në jetën e tyre pranverore nën derdhjen e gëzofit dhe të pjalmnin ballin me freskinë dhe aromën e tyre. Ata ishin sikurse bora që bie për herë të parë në sytë tanë. Dhe tashmë ishin fshirë. Atje nuk ishte bishtalecja ime e dashur e fëmijërisë, nuk binte më borë që ta shembja me sa forcë që kisha atë bullafiqe të vogël, me të cilën kaloja mjaft kohë. Dhe pastaj t'i thoja se shumë e shumë e doja... dhe kur të rriteshim... Ah, kur u rritëm. Kur u rritëm? Doja t'i thoja: "Më pëlqen të jem i vjetër në moshë kaq të re". Mblidhnim mana me të dhe laparosesha unë e ajo qeshte me dënesë. Hapësirat e gojës, faqet, flokët, duart, këmisha ime me mana. Pastaj rrokullisesha bashkë me të si brumë në lëndinë dhe e mbyllja në errësirën e ëndërrave të mia, atë xixllë me duart e vockla, atë vajzushkë ku gishtat e hollë të saj më ledhatonin ëndërrat.

Dhe akoma peltja e vetme që unë do të ha është peltja e manave. Manat që mblidhnin doçkat e saj ishin më të mirat. Ajo ishte e qeshur. Dhe qeshte derisa e zinte kolla. Më shumë se një kollë ishte dhe koha që ndryshonte shpesh. Dhe ajo pastaj tentonte të ndalonte kollën derisa dukej sikur po ia merrte frymën e saj. Derisa nga larg i sollën një makinë. E atë e mbante me vete. Që e vogël kishte punë me frymëmarrjen. Ajo makinë duket se më ndjek edhe tani. Ajo duket me sy të gjelbër gjatë natës dhe qëndron në derën e hapur që kurrë nuk e kuptoj pse duhet të qëndrojë atje. Dera prej saj asnjëherë nuk u mbyll. Mbeti e fshehur në atë makth ku insistonte të bëhej palë me mua në të njëjtin korridor që do të deshte të ishte dhe gjyshi im. Unë kam dashur gjithmonë të rend si i çlirët pas kësaj ane të shtëpisë. Magjia që kishte shtëpia tashmë ishte zhdukur. Ajo kishte hyrë thellë në ëndërra të gjata e të largëta. Fshiva sytë, ndërsa po zgjasja duart tek manat në tryezë, ndjeva se aty strukej diçka më e magjishme, ndjeva se ende po e ndiqja magjinë, që ulej në papafingo të shtëpisë që nuk e pashë kurrë. Nuk bliheshin memorjet...

(Fragment nga romani: „Shtëpia në Kornizë")

# ENDE MES NJË DILEME TË SË SHKUARËS PËR TALENTET FEMRA

Shumë nga poezitë e talenteve femra të botuara në pragun e fundit të rënies së diktaturës, duket se kanë një liri më të madhe shprehish, dëshirash dhe vullnetesh, janë më të çliruara nga ndjesi të ngurta ideo-diktuese. Poezi të tilla në heshtjen e pavëmendshme duket se janë të ndikuara nga rrjedha e botimeve në gazetën „Zëri i Rinisë“, që në atë kohë pati më shumë arsye të ishte e tillë, pasi drejtohej nga disa pena të konceptit „liberal“, sikurse përmendet në biseda kolegësh. Poezitë, duket në fakt se janë të ndikuara nga vetë botuesit e asaj kohe në ktë gazetë, puna e hershme e të cilëve, po reflektonte një mori risish të reja, (dhe kjo jo gjithnjë) në një mënyrë apo formë që solli dhe përdori shumë imazhe të perceptuara, disa prej të cilave deri në një ndryshim në fund të viteve 1990-të, që përkoi me shembjen e mureve të stisura ideo-diktuese. Në një formë a në një tjetër, poezi të tilla, sidoqoftë mbetën dhe janë shumë larg përfaqësimit të trupit femëror, pasi ende mendohej dhe shfaqej në problematikë, ajo që menjëherë qaste si të tillë gjininë femërore. Në fakt mendimi i këtyre botimeve ishte se poezitë e kohës ishin dashuruar me fjalën „e shkathët“, e cila dukej se përshkruante saktësisht, se si duhet të jetë një poet a poete, por përveç kësaj thelbi qëndronte tek vetë qasja që ishte e intriguar nga ideja e artit, që nuk mund të deklarojë gjininë. Kur ndjek idenë për poezinë në këtë nismë të paduskshme e të pavëzhguar në këtë këndvështrim, sheh se sa reciprok mund të jemi, veçanërisht si lexues, në supozimet tona rreth ndikimit të gjinisë në të shkruar. Në fakt poezi të tilla „I bëmë të gjitha lodrat“; „Vajzëria la shenjë“; „Diku jam ndalur e po të pres“; „Trokitja e takave të vajzave“; „Fshehtësi“; „Jemi larg“; „Mall“ janë vetëm poezi të autores Pranvera Osmani, që mbetën të botuara më 21 Maj 1988 në gazetën e asaj kohe „Zëri i Rinisë“. Po ashtu edhe poezi të tilla si „Baresha“ („Drita“ 22 maj, 1988, faqja 9) e autores Vllasova Musta u përcollën vetëm me këtë risi botimi, ashtu sikurse poezitë e autores Gentiana Minga, „Më zgjoi“; „Jemi ne“ („Zëri i Rinisë“, 7 maj 1988).

Një pyetje e lidhur me këtë dukuri të pavëmendshme të kohës që i botoi, dhe më pas të kohës që i harroi, më ka trokitur në kokë gjatë muajve të fundit: „A shkruajnë gratë vërtet poezi të ndryshme nga burrat dhe, nëse po, çfarë mund të thuhet për të karakterizuar poezinë femërore“? Rasti që nxiti pyetjen ndodhi teksa kërkimet e mia ndeshën në emra dhe poezi të tilla, të harruara, të lëna në errësirë, të paragjykuara nga kohërat, në një kohë kur poezisë i mungon vetvetiu „Shoqëria e Poezisë“, edhe pse rrjetet sociale e kanë bërë një lumë a një mol ku përditë e më shumë. Nakatoset vetë poezia, si një arsye më shumë për stacionin e munguar të e të domosdoshëm të ndalesës në fjalë. Në jo pak festivale të sotme kombinacione dhe organizime të shumta përkojnë me atë që është quajtur „Poema Femërore“, të cilën shpesh herë e mburr vetë suksesi me një panel të shquar shkrimtarësh, si Maureen Duffy, Annie Freud dhe Pascal Petit. Në leximin e shkuar të poezisë shqipe, prej talenteve femërore, të tilla si Vojsava Nelo, që pikërisht në majin e 1988 sillte „Çeli kjo ditë“; „Kush thirri poshtë dritares sime“ („Drita“, 1988, 29 maj, fq. 8-9) lexohet edhe kjo gjë që sugjeron se tema është urgjente, dhe jo vetëm për gratë, audienca ende mbetet e përzier. Por një pyetje tjetër mbetet në kapërcimin e sotëm të pas nëntëdhjetës, me një arsye më shumë për tu ndikur ose jo, në mënyrë të barabartë nga pyetja në fjalë që u shtrua më sipër. Duhet qartësuar se natyrshëm variojnë gjithnjë mendimet për gjininë të mbizotërojnë, sigurisht jo në kthim pas, apo në sfumim, në mënyrë që gjuha të na çojë në vende, karaktere dhe identitete që nuk mund t'i parashikojmë gjithmonë. Është mjaft e qartë se mendime të tilla nuk pritet të mbeten të prera me thikë nga poetët burra, megjithëse poezia e tillë vendoset si një lloj mënyre e paracaktuar, duke përsëritur idenë e Simone de Beauvoir se „burri përcaktohet si qenie njerëzore dhe gruaja si femër“. Pra, ndërsa gratë lexuese janë të lumtura të gllabërojnë gjithçka që është e mirë, lexuesit meshkuj ndonjëherë janë nervozë nga librat me poezi nga gratë, ato me përvojë editoriale mes nesh kanë shkruarse ishte dhe është e vështirë që burrat të bënin rishikimin e librave të grave, sikur një ekspertizë e ndryshme, e specializuar është ende e nevojshme. Është e nevojshme edhe për vetë faktin e ekzistencës krijuese, dhe për vetë fatin dhe faktin e diskursit krahasues, pa të cilin nuk mund të ecet përpara. Ndryshe poezi të tilla të pëlqyera si „Vajzat“ apo „Pritje“ („Zëri i Rinisë“, 1988, 7 maj) të një autoreje të cilësuar talente, që na kujtoi guximin, sikurse ishte Rexhina Prela, do të mbesin mes fletëve të verdha të arkivave, nëse dikush do të mundet të hedh një sy në kohëra të tjera. Kjo të bën të mendosh se sa e pakëndshme është të jesh i mbyllur, dhe të mendosh se si është më keq, mbase, të jesh i harruar. Ne të gjithë duhet të shijojmë njëtrajtësisht lirinë e zhvendosjes së kufijve ideologjikë, të shembur tashmë, por edhe të atyre që qasen tek polarizmi ekstrem i mashkullit dhe femrës. Kjo nuk përshtatet domosdoshmërisht me thelbin se kush jemi dhe si shkruajmë. Poeti mund të zhvendoset përgjatë një vazhdimësie të feminitetit dhe maskulinitetit në poezi për të prodhuar efektet ose personazhet e nevojshme dhe të sfumojë kohërat, vetëm kur arti është art, dhe këtë e bëri ndoshta vetë „Zëri i Rinisë“ me takt. Menjëherë mendon për poetë që e bënë këtë herët në kombe të tjera, si Keats, ose Dickinson. Siç mund ta merrni me mend, nuk ka ndonjë marrëveshje përfundimtare nëse ekziston një ndjeshmëri poetike e dukshme femërore, edhe pse disa mendojnë se mund të përcaktohet një hapje unike ndaj botës dhe trupit në shkrimet e grave, të tjerë sot mendojnë, se këto janë mundësi interesante për çdo shkrimtar, ashtu si territoret që mund të shihen si veçanërisht mashkullore dhe gjithnjë janë dhe duhet të jenë të hapura për të gjithë.

Kur shkruanin dhe botonin emrat e talenteve të lartcituara, kishte dhe emra të tjerë lokalë, që botonin në gazetat lokale, si Valbona Musaku, Ilirjana Resuli, Eneida Mata, Katjusha Latifi, Albana Shala, Vitori Zaka, Lavdije Shqiponja, etj., por ato janë vetëm në arkiva, ndoshta ende mes dilemës së trajtimit si art i fjalës poetike, që i përket kohës së ngurtë ideologjike.

# NJË ROMAN QË NGRE LART DHE NDERON SHQIPTARËT

Para disa ditësh, me një rekurs kohor si shkak i Pandemisë dhe mjaft ndodhive të tjera personale, në takimin e radhës me Ambasadorin e Shqipërisë në Londër, Qirjako Qirko biseda përveç të tjerave preku dhe një tematikë të njohur që lidhet me ndihmën e popullit shqiptar në kohën e Luftës së II Botërore ndaj komunitetit Hebre. Ndërsa biseda shkonte në shtratin e saj, Ambasadori e ndjente krenari të ritregonte emocionet e një ekspozite të Yad Vashem Britani e Madhe të organizuar nga Bordi i Deputetëve në Angli mbi heroizmin e shqiptarëve për shpëtimin e hebrenjve. Ekspozita sipas ambasadorit kishte disa efekte. Kryesori ishte se hebrenjtë britanikë mësuan aty më shumë për heroizmin e shqiptarëve, që shpëtuan hebrenjtë gjatë pushtimit nazist. Ambasadori Qirko, tregoi se kur iu drejtua publikut të pranishëm duke u thënë se "historia e mbrojtjes së popullsisë hebraike në Shqipëri është e jashtëzakonshme", duke shtuar se ishte "një shembull i shkëlqyer i njerëzimit dhe një mësim për brezat e ardhshëm", ata shpërthyen në duartrokitje. Duartrokitje të tilla janë ndjerë vetëm në ditët kur Covid-19 pushtoi Botën dhe kur në rrugët e Britanisë së Madhe, i madh e i vogël, pa dallim, duartrokisnin herronjtë e NHS. Ngjashëm? Ndoshta me një lidhje të thjeshtë, që tregon se të gjithë luftërat bëjnë një gjë të mirë, sjellin mesazhe bashkimi dhe respekti, sakrifice të njeriut për njeriun. Me këtë preambulë është përgjigjur për mediat edhe autorja e librit, „Out of the Mountain's Shadow" (Jashtë Hijes së Malit), Rose Alexander, ndërsa në thelbin e këtij libri ka vendosur dashuri dhe dhimbje të frymëzuar nga histori të vërteta. Ajo është shprehur, ndërsa libri i saj emocional ka parë dritën e botimit më 10 qershor: "Në rrugën time në Kentish Town, të gjithë duartrokitën së bashku, bënë blerje ndihmash për të tjerët, bënë bamirësi dhe u futën për të ndihmuar fqinjët. Kjo bëri një lidhje të bukur me librin tim. Unë shpesh kisha menduar nëse njerëzit në ditët e sotme do të ishin aq të guximshëm dhe vetëmohues si shqiptarët për të cilët kam shkruar dhe ka qenë ngrohëse e zemrës për të parë që ne nuk e kemi humbur plotësisht atë aftësi. Padyshim, pandemia nuk është aspak si tmerri dhe persekutimi i Holokaustit, por megjithatë ka qenë mirë të shohësh që njerëzit mund të veprojnë në mënyrë altruiste dhe diçka pozitive mund të dalë nga ngjarjet e tmerrshme të vitit të kaluar." Dhe shqiptarët e bënë këtë në kohë të vështirë lufte, kur rrezikohej jeta e tyre. E ata e bënë për të shpëtuar Tjetrin. E me Tjetrin madje ndërtuan dhe linja dashurie. Në Shqipëri, është zakon që t'u ofrohet mysafirëve besnikëri dhe mikpritje dhe të garantohet siguria e tyre. Sapo një shqiptar t'i ketë dhënë një mysafiri fjalën e tij, 'besën' e tij, ai duhet ta zbatojë atë. Është kjo traditë që kontribuoi për t'u dhënë hebrenjve nga e gjithë Evropa strehë të sigurt gjatë Luftës së Dytë Botërore. Me këtë kod të "Besa" në romanin e autores vijon linja e dashurisë së shqiptarit Bekim me vajzën Hannelore. Një dashuri thuajse me shikim të parë. Në narrativ dashuria lind si një shkëndijë fëminore, ndërsa zjarri i luftës dhe rreziku i pushtuesit të egër nazist kërkon të djegë e të shkatërrojë çdo gjë. Kjo linjë shkon në një arsye të thellë, në detaje të rëndësishme në roman, dhe mesazhi është mjaft i bukur, shpëtimi i jetës së Tjetërit, pa marë parasysh asgjë, edhe humbjen e jetës tënde. Kjo është dashuria e shqiptarëve e bekuar në kodin e tyre antik "Besa", të cilin narrativi i romanit e bën mjaft të gjallë. Ajo që fillon si besa e Bekimit ndaj familjes së Hannelore, zhvillohet në dashuri ndërsa ai bën gjithçka që ka mundësi për t'i mbajtur ata të sigurt. Në këtë lidhje natyrshëm është ajo që ndodhi në vitin 1939, e më pas me ikjen e fashistëve italianë, pushtuesi tjetër nazist e bën më të zhdërvjellët situatën. Ata që strehuan hebrenjtë, ishin shqiptarë të varfër, por kishin një zemër të madhe. Ky detaj bëhet transparent dhe në tërë arsyen e narrativit ndjek familjen hebreje, që gjen vend të shenjtë në Shqipëri, pasi u arratis nga Austria dhe nga ngjarjet e Kristallnacht. Kështu në roman tregohet një pjesë kryesisht e panjohur e Holokaustit, po aq sa të dy linjat e dashurisë në kohë dhe hapësirë tjetër thuajse gjenë pikëtakimin e tyre në Italinë e vitit 2019-të kur një amanet dhe një dashuri tjetër zgjon kërkimet e mëtejshme të artefakteve në malet e Shqipërisë. Në këtë linjë janë Ruth dhe Zak, ata që kërkojnë të shkojnë deri në fund të asaj që narrativi e qas si zgjidhje e një misteri për babanë e tij që po vdes. Në roman mësojmë për Bekimin të bëhet një partizan që lufton për të fituar lirinë e vendit të tij, po kaq lotët dalin vetvetiu kur Hannelore u largua nga Shqipëria për në Amerikë. Nga ana tjetër linja e dashurisë së vitit 2019, ajo mes Zak dhe Ruth, natyrisht është një linjë që i duhet romanit për të ndriçuar mjaft enigma, tek të cilat lexuesi jo vetëm lexon, por kupton qartë shumë gjëra që lidhen me vyrtytin e besnikërisë së shqiptarëve në shekuj. Alternimi midis historisë së Bekimit, të ndodhur në vitet e Luftës së II-të Botërore, dhe asaj të Ruth dhe Zak në të tashmen, pikërisht në vitin 2019, është një përzierje e përsosur. Zak, duke qenë djali i Bekimit, që jeton në Itali për vetëm tridhjetë vjet, duke takuar Ruth, e cila po qëndron me pushime në një apartament, pikërisht në rrugën ku jeton ai. Zak duke i dhënë Ruthit historinë e jetës së babait të tij dhe Ruth, si një ish-gazetare e hetimeve, është e zhytur plotësisht në historinë e dashurisë së Bekimit me Hannelore. Sigurisht interesante është dhe mbetet vajtja në Shqipëri, ku Ruth takon edhe prindërit e Zak. Sidoqoftë, në të dy historitë, personazhet e pasurojnë thelbin e kodit shqiptar të "Besa", që shkon në narrativ duke vendosur nevojat e të tjerëve në radhë të parë.



# NJË FOTOGRAFI QË SHKON MJAFT TEJ NË ORIGJINË

Pra disa ditësh një fotografi dhe një shënim i vogël i Ambasadores së Jashtëzakonshme dhe Fuqiplotë të SHBA-së në Shqipëri, Yuri Kim, duket se ceku vetëm njërën anë të saj. Publikimi i saj fliste me gjuhën e vetë fotografisë për një vizitë të vetë ambasadores në Kishën e Shna Ndout në Laç. Ajo që u shënua ishte një koment që shoqëroi fotografinë. Komenti i Ambasadores së SHBA ishte ky: „Si mijëra njerëz në Shqipëri, vizitova Kisha e Shna Ndout në Laç këtë mbrëmje për të thënë një lutje të veçantë. Kur isha duke u rritur në Guam, shkova në shkollën St. Anthony. Unë kurrë nuk mund ta imagjinoja një ditë se do ta gjeja Anthonin e Padovës në Shqipëri. Le të na ndihmojë Shën Antoni për të gjetur atë që ka humbur. Ju ndihmoftë". Këndi me të cilin u pa kjo fotografi dhe komenti që e shoqëroi fotografinë u rrethrotullua rreth fakteve të mësuara nga shënimi i Ambasadores që thoshte së pari, se është surprizuar gjatë vizitës në Kishë, dhe së dyti, pasi nuk e kishte menduar që do të gjente Shën Antonin e Padovës në Shqipëri. Së treti Ambasadorja tregon se kur jetonte në Guam, kishte shkuar në shkollën me të njëjtën emër. Pra të trija këto përbëjnë një kënd të shikimit të fotos dhe po aq të komentit që e shoqëron atë. Po ana tjetër dhe realiteti ku qëndron? Për këtë së pari le të sqarojmë se kush dhe si emri i shenjtorit mbërriti deri në këtë pikë. Në Shqipëri njihet si Shën Antoni i Padovës. Anthony, ose Antony of Padova, ndryshe dhe Anthony i Lisbonës ishte një prift katolik Portugez dhe frat i Urdhrit Françeskan. Ai lindi dhe u rrit nga një familje e pasur në Lisbonë, Portugali, dhe vdiq në Padova, Itali. Por ajo që e bën më interesantë këtë fotografi dhe këtë moment të Ambasadores së SHBA-së shkon përtej këtij këndi të analizës dhe vështrimit momental, pasi Shën Antoni i Padovës ka dhe disa lidhje me një legjendë dhe disa të dhëna që e shoqëruan predikimn e tij. Legjenda e vitit 1630 thotë se ai predikonte për peshqit. Kjo legjendë si e „predikimit të peshkut", filloi nga breglumi Marecchia i Riminit, ku ai kishte shkuar për të predikuar. Kur heretikët e atjeshëm e trajtuan me përbuzje, Shën Antoni u tha atyre, por me të njëtën faturë fjalësh, se kishte shkuar në bregdet, ku shtoi se kishte filluar të predikonte në buzë të ujit. Sa filloi predikimin e tij, një turmë e madhe peshqish u pa të mblidheshin para tij. Njerëzit e qytetit u dyndën për të parë këtë mrekulli, pas së cilës Shën Antoni i akuzoi ata, për faktin se peshqit ishin më të pranueshëm ndaj mesazhit të tij, sesa heretikët e kishës. Në atë moment njerëzit u prekën për të dëgjuar mesazhin e tij. Në një tjetër histori të rrëfyer shpesh, e cila ndodhi në Toulouse, Shën Antoni u sfidua nga një heretik për të provuar realitetin e pranisë së Vërtetë të Krishtit në Eukaristi. Njeriu, i cili kërkoi të tallej me Shën Antoni, nxori një mushkë gjysmë të uritur dhe i tregoi asaj foragjere të freskëta në njërën anë, dhe mikpritësin e sakramentit nga ana tjetër. Thuhet se mushka kishte injoruar foragjeret dhe në vend që të hante, u përkul para sakramentit. Një rrëfim tjetër tregon për një rast në Itali kur Shën Antoni po darkonte me disa heretikë. Ai e kuptoi që ushqimi që i kishin vënë përpara ishte i helmuar dhe ai u përball ndryshe me ta. Burrat pranuan se u përpoqën ta vrisnin, por më pas e sfiduan atë për të ngrënë nëse ai vërtet i besonte fjalëve të thëna te Marku 16:18 për apostujt e Krishtit: „... dhe nëse pinë ndonjë gjë vdekjeprurëse, nuk do t'ju dëmtojë". Thuhet se Shën Antoni pasi e ka bekuar ushqimin, e ka ngrënë dhe nuk ka pësuar asnjë dëm, për habinë e atyre rreth tij. Në këndin që shfaqet fotografia, është padyshim vendi i shenjtë, por ai shënjohet nga qasja në art. Në art është statuja e Shna Ndout, ajo që bashkon dhe me art bën lidhjen e komentit dhe vizitës në fakt. Arti ishte ai që bëri dhe fiksoi dallesën, ashtu sikurse dhe me artin që fikson Shna Ndoun. Kjo për faktin real që lidhet me faktin, ndërsa numri i shenjtorëve françeskanë rritej, ikonografia u përpoq të dallonte Shën Antonin e Padovës nga të tjerët. Për shkak të legjendës, që ai dikur i kishte predikuar peshqve, sikurse e sqaruam më lart, nga gryka e lumit Marecchia në Rimini, kjo ndonjëherë përdorej si atribut i tij. Ai gjithashtu është parë shpesh me një kërcell zambaku të bardhë, që përfaqëson pastërtinë e tij. Konventa të tjera i referoheshin entuziazmit vizionar të Shën Antonit. Kështu, një atribut në përdorim për disa kohë ishte një zemër e ndezur. Ai gjithashtu është përshkruar ndonjëherë së bashku me mushkën në Rimini, që pretendohet se iu përkul atij duke mbajtur Eukaristinë. Në vitin 1511, Titian pikturoi tre afreske të mëdha në Scuola del Santo në Padova, duke përshkruar skena të mrekullive nga jeta e Shën Antonit: Mrekullia e Burrit Xheloz, e cila përshkruan vrasjen e një gruaje të re nga burri i saj; Një fëmijë që dëshmon për pafajësinë e nënës së tij; dhe Shenjtori që shëron të riun me një gjymtyrë të thyer. Një model tjetër kryesor e bën atë të meditojë mbi një libër të hapur në të cilin shfaqet vetë Fëmija i Krishtit, si në El Greco më sipër. Me kalimin e kohës fëmija u tregua shumë më i madh se libri dhe disa imazhe madje edhe pa librin plotësisht. Ai zakonisht

shfaqet duke mbajtur foshnjën Jezus dhe duke mbajtur një kryq. Në ofertat popullore Shën Antoni i Padovës shpesh përshkruhet duke shpëtuar për mrekulli individë në aksidente të ndryshme. Ngjashëm për Shna Ndoun është emri, është dhe arti, janë dhe legjendat, janë historitë, rrëfenjat dhe mbi të gjitha besimi popullor. Kisha e Shën Antonit (shqip: Kisha e Shna Ndout, ose Kisha e Laçit), është një kishë e ndërtuar fillimisht në 1300, pastaj u shkatërrua në 1971, dhe përfundimisht u rindërtua në vitet 1990 në qytetin shqiptar të Laç. Vendi i kishës u ndërtua për herë të parë rreth vitit 1300 dhe i kushtohej Shën Marisë, më pas u riemërua pas Shën Antoni i Padovës në 1557. Në 1971 ajo u shkatërrua nga regjimi komunist, dhe më në fund u rindërtua në vitet 1990. Isshtë një kishë françeskane. Shumë klerikë të njohur kanë shërbyer në kishë, përfshirë Shtjefën Gjeçovi, Vinçens Prennushi, Klement Miraj, Robert Ashta dhe Zef Pllumi. Sot, ajo është një atraksion turistik i njohur. Që nga fundi i komunizmit, janë bërë përpjekje gjithashtu për të prozelitizuar shumicën myslimane në Shqipëri drejt katolicizmit dhe për të bindur myslimanët sunitë, si dhe anëtarët shiitë të rendit sufist Bektashi, të bashkohen me udhëtimet që çdo vit bëjnë rrugën e tyre për në ndërtesa më 12 qershor.

DAILY FRESH HALAL MEAT AND FRUIT
HILAL FOOD CENTRE
International Food Centre
HALAL
318-324 Kilburn High Road,
London, NW6 2QN
020 7372 1059
VEAL SPECIAL OFFER
INDIAN HEAD
Old Fashioned
STONE GROUND
WHITE
Halal
Gulasch
Beef goulash
KLAS
SARAJEVO
Zlatni
Govedi Narezak
VITA BÔNOR
lane
VEGETA
All Purpose Seasoning
PODRAVKA
paprika
ARGETA
Chicken
Halal